




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## Raporti i Auditimit të Performancës

---

# EFEKTIVITETI I INSTITUCIONEVE NË TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Prishtinë, Gusht 2023



---

Pjesa e asistencës teknike ne këtë raport është mbështetur nga UN Women brenda kornizës së programit “Financimi transformativ për Barazi Gjinore drejt një qeverisjeje më Transparente, Gjithëpërfshirëse dhe Llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor” i cili implementohet në nivel rajonal dhe financohet nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida).

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000<sup>1</sup>) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë<sup>2</sup>, efikasitetit<sup>3</sup> dhe efektivitetit<sup>4</sup> dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës “Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Ariana Gjonbalaj Shala, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Ardiana Miftari, Udhëheqëse e Ekipit

Ylfete Osmani, Anëtare e Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - Adresa: Lagjja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi 210, Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +381(0) 38 60 60 04/1011

---

1 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

2 Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

3 Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

4 Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

# Tabela e përmbajtjes

## Lista e shkurtesave

|                                                                       |           |
|-----------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Përmbledhje e përgjithshme .....</b>                               | <b>1</b>  |
| <b>1.Hyrje.....</b>                                                   | <b>4</b>  |
| <b>2.Objektiva dhe pyetjet e auditimit.....</b>                       | <b>7</b>  |
| Pyetjet e auditimit .....                                             | 7         |
| <b>3.Gjetjet e auditimit.....</b>                                     | <b>9</b>  |
| 3.1. Linja telefonike për thirrje emergjente .....                    | 14        |
| 3.2. Intervenimi i patrullës policore .....                           | 15        |
| 3.3. Marrja e deklaratave të para nga pjesëmarrësit në konflikt ..... | 16        |
| 3.4. Reagimet post-urgjente .....                                     | 25        |
| 3.5. Vendimmarrja dhe procedurat e mëtutjeshme .....                  | 32        |
| 3.6. Baza e përbashkët e të dhënave .....                             | 37        |
| <b>4.Konkluzionet .....</b>                                           | <b>46</b> |
| <b>5.Rekomandimet.....</b>                                            | <b>49</b> |
| <b>Shtojca 1. Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....</b>     | <b>53</b> |
| Fushëveprimi i auditimit .....                                        | 53        |
| Metodologjia e auditimit .....                                        | 54        |
| <b>Shtojca 2. ....</b>                                                | <b>55</b> |
| <b>Shtojca 3. Letër konfirmimet .....</b>                             | <b>63</b> |

# Lista e shkurtesave

|        |                                                    |
|--------|----------------------------------------------------|
| MD     | Ministria e Drejtësisë                             |
| PSV    | Procedurat Standarde të Veprimit                   |
| QPS    | Qendra për Punë Sociale                            |
| UA     | Udhëzim Administrativ                              |
| ZKA    | Zyra Kombëtare e Auditimit                         |
| ZMNV   | Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave             |
| ZKNDHF | Zyra e Koordinatorit Nacional për dhunë në familje |
| UM     | Urdhër mbrojtje                                    |
| UME    | Urdhër mbrojtje emergjente                         |
| UMPE   | Urdhër mbrojtje e përkohshme emergjente            |
| SP     | Stacion Policor                                    |
| DBN    | Data Baza Nationale                                |



# Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës “Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”. Trajtimi i rasteve të dhunës në familje, bëhet nga një numër i institucioneve si: Policia e Kosovës, Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave, Prokuroria themelore, Gjykatat themelore, Qendrat për punë sociale dhe Strehimoret, të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme nëpër faza të caktuara. Objektivi i këtij auditimi ka qenë vlerësimi nëse institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë aktivitetet dhe masat e duhura për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, siç janë reagimi, mbrojtja dhe rehabilitimi i viktimave të dhunës, për të siguruar mbështetje dhe përkrahje institucionale.

Ky auditim është fokusuar në procesin e trajtimit të rasteve të raportuara të dhunës në familje, që nga momenti raportimit në polici deri tek përcjellja e rasteve në gjykata, me fokus të veçantë në dy regjione: Regjionin e Prishtinës dhe Regjionin e Pejës për shkak se këto dy regjione kanë numrin më të madh të rasteve të raportuara të dhunës. Ky auditim ka përfshirë periudhën 2020-2022.

Rezultatet tona të auditimit tregojnë se edhe pse institucionet përgjegjëse publike kanë ndërmarrë një sërë veprimesh për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave. Për të realizuar efektivitetin e shërbimeve të ofruara kërkohet më shumë angazhim institucional. Sistemi shtetëror ka mangësi në angazhimin e hetuesve primar, përfshirje të mbrojtësve të viktimave, shqyrtim të rasteve me kohë nga organet e drejtësisë, si dhe regjistrim të rasteve të raportuara. Viktimat nuk kanë përkrahje sociale, në veçanti mungon përkrahja e tyre në aspektin ekonomik. Gjithashtu, mungojnë programet për trajtimin e kryesve të veprës.

*Ka mangësi në angazhimin adekuat të burimeve njerëzore, në procedurat e monitorimit dhe në mbështetjen e viktimave gjatë rehabilitimit.* Policia gjatë intervenimit dhe ofrimit të shërbimeve emergjente reagon në kohë optimale, mirëpo janë identifikuar dobësi në angazhim të hetuesve policor, mungesë e procedurave për monitorimin e urdhrave mbrojtës, mos përcjellje e informatës tek mbrojtësit e viktimave si dhe dobësi në regjistrimin e rasteve. Nga ana e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, janë vërejtur raste të pa trajtuara, mangësi në përfshirjen e tyre gjatë gjithë procesit si dhe dobësi në udhëzimet për kompensim të dëmit. Kurse në Qendrat për punë sociale ka mungesë të përcaktimit të punëtorëve social të cilët duhet të merren vetëm me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe mungesë të trajtimit të kryesve të veprës.

*Nga institucionet e drejtësisë përkatësisht Gjykatat janë evidente vonesat në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.* Gjykatat themelore, ende ballafaqohen me bartje të lëndëve të pazgjidhura nga vitet paraprake, ku disa prej tyre janë që nga viti 2016. Në bazë të statistikave të ofruara kemi vërejtur se procesi i trajtimit në procedurë penale tek rastet e dhunës në familje merr kohë më shumë se një vit. Sa i përket lëndëve civile të pranuar, si dhe nga kush janë parashtruar kërkesat për shqyrtimin e tyre, vërejmë se në Gjykatat Themelore kërkesat për urdhër mbrojtje bëhen nga ana e mbrojtësve të

viktimave, nga pala e mbrojtur si dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur, siç edhe kërkohet me procedura.

*Mungesa e angazhimit institucional në regjistrimin e të dhënave në Data Bazën Nacionale për rastet e dhunës në familje.* Policia e Kosovës është njëri nga institucionet përgjegjëse që bën regjistrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse të dhënave në këtë data bazë. Një mungesë e theksuar e regjistrimit të të dhënave është vërejtur në Gjykatat Themelore dhe Prokurorinë e Pejës. Po ashtu, rastet e regjistruara në DBN nuk klasifikohen apo priorizohen në bazë të ndjeshmërisë së tyre. Kjo pengon mobilizimin efektiv dhe planifikimin e duhur të aktiviteteve për adresimin e rasteve specifike të dhunës në familje.

Për përmirësimin e këtij procesi janë dhënë gjithsej 19 rekomandime për 6 institucione, sipas defekteve të identifikuara: 3 rekomandime për Policinë e Kosovës, 3 për Zyrën për Mbrojtje dhe ndihmë Viktimave, 4 për Qendrat për Punë Sociale, 2 për Prokurorinë Themelore, 2 për Gjykatat Themelore si dhe 5 për Ministrinë e Drejtësisë. Lista e rekomandimeve është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

### **Përgjigja e palëve të përfshira në auditim**

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Qendra për Punë Sociale në komunën e Pejës, Ministria e Drejtësisë dhe Policia e Kosovës janë pajtuar me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit. Ndërsa nuk kemi pranuar letër konfirmim nga Prokuroria Themelore Prishtinë, Prokuroria Themelore Pejë, Gjykata Themelore Prishtinë, Gjykata Themelore Pejë si dhe Qendra për Punë Sociale në komunën e Prishtinës.



HYRJE

01

# 1. Hyrje

Sipas konventave ndërkombëtare dhuna në familje është njëra nga format e shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut.<sup>5</sup> Kjo dukuri e cila ka përmasat e veta edhe në shoqërinë tonë vazhdon të jetë njëra nga format e keqtrajtimit njerëzorë që në disa raste përfundon me fatalitet. Nuk ka ndonjë përkufizim universal të dhunës në familje, megjithatë, në Kosovë përkufizohet si vijon: veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton me abuzim kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën.<sup>6</sup>

Dhuna në familje është dukuri që shumicën e rasteve ndodhë jashtë syve të publikut, por pasojat e saj prekin komunitetin më të gjerë dhe është shkak themelor i një game më të gjerë anomalish sociale.<sup>7</sup>

Duhet të theksojmë se para ndryshimeve të fundit legjislative, instrumentet shtetërore në dispozicion për ta eliminuar pabarazinë kanë qenë të kufizuara në aspektin e orientimit ndaj dhunës në familje. Kjo është vërtetuar edhe nga hulumtimi i bërë në vitin 2019 nga OSBE, ku theksohet mungesa e mekanizmave shtetëror dhe nevoja e fuqizimit të institucioneve për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje.<sup>8</sup>

Format e dhunës në familje janë të kategorizuara si keqtrajtimi fizik, psikologjik, seksual e deri tek ai ekonomik.<sup>9</sup> Grupet më të rrezikuara për t'u ekspozuar më së shumti ndaj dhunës së ushtruar në marrëdhëniet familjare, paraqiten gratë, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, si edhe personat LGBT.<sup>10</sup> Në rastet kur traumat shfaqen si sjellje të dhunshme, në veçanti tek gjinia mashkullore, nëse këto raste nuk trajtohen dhe përkrahen me kohë gjendja e tyre do të vazhdojnë njësoj apo edhe mund të rëndohet.<sup>11</sup>

Dhuna në familje përfshinë të gjitha moshat dhe gjinitë pa dallim, prandaj është e rëndësishme ndërtimi i mekanizmave të fuqishëm mbrojtës që ta parandalojnë dhe luftojnë këtë dukuri. Kundrejt kësaj dukurie të shprehur në mesin tonë, ka pasur reagime si nga aspekti qeveritarë ashtu edhe nga spektri i gjerë i

5 Konventa e këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. <https://rm.coe.int/168064d3f6>

6 Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 2.1(1.1): E definon si të tillë mes personave që janë/kanë qenë: janë apo kanë qenë të fejuar, janë apo kanë qenë të martuar; janë apo kanë qenë në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët, si dhe përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë, janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare; <http://www.assemblykosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>

7 Impact evaluation of Mandatory protection measures on domestic violence, Evaluation society in Bosnia and Hercegovina, Fq13 <https://www.researchgate.net/publication/351006179>

8 Anketa për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë, 2019, OSBE

9 Raportimi për dhunën në familje, Nëntor 2018, udhëzues për gazetarë, OSCE <https://www.osce.org/files/f/documents/1/7/404351.pdf>

10 Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2016-2022 Procedurat standarde të veprimit <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombe%CC%88tare-pe%CC%88r-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne%CC%88-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%93-2026.pdf>

11 Intervistë me psikologe në Qendra për punë sociale në Prishtinë-Njësi Bregu i Diellit


komunitetit jo qeveritarë. Këto angazhime kanë rezultuar me themelimin e një numri të organizatave që merren ekskluzivisht me dhunën në familje, hartimin e një kornizë të gjerë legjislative që definojnë masat ligjore, si dhe përcaktimin e veprimeve afatshkurtra apo afatgjata të organeve kompetente.

Nisur nga aspekti i hartimit të politikave, objektivat kryesore strategjike janë paraparë qysh me strategjinë e parë të vitit 2016/22. Objektivat e kësaj strategjie me pak ndryshime kanë qenë pikat kryesore referuese edhe në strategjinë pasuese 2022/26.

Vlen të ceket se po ashtu edhe shtyllat kryesore të angazhimeve strategjike shtetërore janë të bazuara në reagim, mbrojtje dhe rehabilitim të viktimave të dhunës në familje.<sup>12</sup>

Në grafikun e mëposhtëm kemi paraqitur në numrin e rasteve të raportuara të dhunës në familje, gjatë tri viteve të fundit në nivel vendi.

**Grafiku 1. Numri i rasteve të dhunës në familje për periudhën 2020-2022**



Nga grafiku mund të vërehet se rastet e dhunës në familje në vitin 2021 janë rritur rreth 19% në krahasim me vitin 2020, ndërsa në vitin 2022 dhuna në familje është rritur rreth 12% në krahasim me vitin 2021.

12 Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022 – 2026 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombe%CC%88tare-pe%CC%88r-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne%CC%88-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%93-2026.pdf>

# OBJEKTIVA DHE PYETJET E AUDITIMIT

02

## 2. Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është që të vlerësojmë nëse institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë aktivitetet dhe masat e duhura për trajtimin e rasteve të dhunës në familje siç janë: reagimi, mbrojtja dhe rehabilitimi i viktimave të dhunës, për të siguruar mbështetje dhe përkrahje institucionale.

Përmes këtij auditimi synojmë dhënien e rekomandimeve që do të mund të kontribuojnë në përmirësimin e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, të kontribuojmë edhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara për viktimat.

### Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit janë parashtruar pyetjet si në vijim:

1. *A reagojnë institucionet përgjegjëse në mënyrë efektive ndaj rasteve të raportuara të dhunës në familje?*
2. *A i mbrojnë institucionet përgjegjëse në mënyrë efektive rastet e dhunës në familje?*
3. *A marrin viktimat e dhunës në familje mbështetje dhe përkrahje të duhur gjatë fazës së rehabilitimit?*

Ky auditim ka përfshirë periudhën 2020-2022 dhe është fokusuar në procesin e trajtimit të rasteve të raportuara të dhunës në familje, që nga momenti raportimit në polici deri tek përcjella e tyre në gjykata.

Auditimi i është përshtatur mënyrës së funksionimit të sistemit të menaxhimit të rasteve dhe është fokusuar sipas kësaj renditje;

- Në nivel qendror, Ministria e Drejtësisë, (tutje MD).
- Në nivel regjional, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (tutje ZMNV), Prokuroritë dhe Gjykatat Themelore, si dhe
- Në nivel lokal, Policia dhe Qendra për Punë Sociale (tutje QPS).

Metodologjia dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në **Shtojcën 1**.

# GJETJET E AUDITIMIT

03

### 3. Gjetjet e auditimit


Ky auditim është bazuar në shtyllat kryesore strategjike, të cilat janë zbërthyer edhe në objektiven e auditimit. Aktivitetet e institucioneve përgjegjëse janë të orientuara në tri drejtime kryesore: reagim, mbrojtje dhe rehabilitim të rasteve të dhunës në familje.

Këto tri çështje janë trajtuar edhe përmes një ankete të zhvilluar në dy strehimore, ku kemi arritur të marrim përgjigje nga 40 gra të strehuara gjatë 2 viteve të fundit, ku qëndrimi i tyre në strehimore ka qenë prej disa javëve deri në 6 muaj. Ky hulumtim është bërë përmes intervistave, të anketuarat janë përgjigjur duke plotësuar në mënyrë anonime një pyetësor. Duhet theksuar se në këto dy strehimore gjatë kësaj periudhe kanë kaluar mbi 600 veta.<sup>13</sup> Duke marrë parasysh se jo të gjitha rastet e dhunës në familje kalojnë nëpër strehimore kjo anketë nuk përfaqëson opinionin e masës së gjerë të këtij grupi. Mirëpo, pasi që këto 40 gra kanë kaluar nëpër të gjithë hapat e trajtimit, anketa e zhvilluar në një masë reflekton një pasqyrë të përshtypjeve të tyre se si ato janë trajtuar nga ana e institucioneve përgjegjëse.

<sup>13</sup> Të dhënat e marra nga strehimorja e Prishtinës dhe ajo e Pejës

Trajtimi i rasteve të dhunës në familje zhvillohet në pesë hapa, të cilat janë paraqitur në diagramin e mëposhtëm.

Diagrami 1. Hapat e trajtimit të rasteve të dhunës në familje, institucionet dhe palët e përfshira në proces





## **Hapi i parë – Linja emergjente telefonike (Reagim)**

Reagimi i parë i mundshëm i viktimës pas incidentit është të thërras numrin e qasshëm për rastet e dhunës në familje 080019999 ose 192 i cili është në dispozicion 24/7, cila thirrje arrin tek dhoma operative policore. Qendra e thirrjeve duhet të pranoj informatën dhe ta përcjellë atë tek menaxheri i ndërrimit në mënyrë që ky informacion të kaloj tutje tek patrulla më e afërt policore. Dispeçeri gjithashtu jep udhëzime të arsyeshme viktimës apo personit që e raporton rastin se cilat veprime të sigurisë duhet ndërmarrë përderisa është duke pritur policinë për të arritur në vendin e ngjarjes.

## **Hapi i dytë – Intervenimi i patrullës policore (Reagim)**

Patrulla e policisë është e detyruar të ndërhyjë menjëherë për të siguruar mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, si dhe të ndalojë kryesin e supozuar me qëllim të parandalimit të dhunës së mëtejshme. Qasja e tyre profesionale dhe serioze ndaj viktimës është shumë e rëndësishme në procedimin e mëtejshëm të ndjekjes penale. Patrulla policore, gjithashtu është përgjegjëse për sigurimin e provave dhe vlerësimin e rrethanave. Zyrtari policor duhet të kërkojë që hetuesit dhe krim-tekniku të dalin në vendngjarje kur ka prova materiale, të kujdeset për plotësimin e të gjithë formularëve të nevojshëm për fillimin dhe plotësimin e rastit i cili i dorëzohet më tutje tek mbikëqyrësi i turnit.

Në rast nevojë, patrulla policore kërkon që në vendngjarje të dalin shërbimet mjekësore dhe ndihma për të lënduarit. Varësisht nga lëndimet, duhet të sigurohet transport për në institucionin shëndetësor për viktimën dhe personat e tjerë.<sup>14</sup>

## **Hapi i tretë – Marrja e deklaratave të para nga pjesëmarrësit në konflikt (Mbrojtje)**

Hetuesi së bashku me mbikëqyrësin e hetimit dhe mbikëqyrësin e ndërrimit përpilojnë vlerësimin e rrezikut për rastin e dhunës në familje dhe informojnë viktimën për shërbimet e tjera të ndihmës. Ky vlerësim i rrezikut përfshin, vlerësimin e dhunës fizike dhe një parashikim të rrezikut të incidentit, marrë parasysh rrethanat dhe provat. Më tutje institucionet tjera përgjegjëse ta kenë më të qartë situatën dhe ndërmarrin veprimet e tyre në konsistencë me këtë vlerësim. Hetuesi gjithashtu është përgjegjës për të informuar viktimën se ai/ajo mund të mbrohet edhe përmes “urdhrit të përkohshëm mbrojtës emergjent” të lëshuar nga policia. Po ashtu, viktimë duhet të njoftohet se ky urdhër mbrojtës nga ana e tyre është lëshuar vetëm për ditët jashtë orarit të punës dhe afati i tij do të përfundojë në ditën tjetër të parë të punës. Ky urdhër duhet të lëshohet nga mbikëqyrësi rajonal i dhunës në familje vetëm me kërkesë të viktimës.

<sup>14</sup> Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje; neni 24 paragrafi 5

Hetuesi duhet të intervistojë viktimën në prani të mbrojtësit të viktimës dhe punonjësit social, ata e ndihmojnë viktimën të vendos nëse do të shkojë në strehimore, dhe e informojnë për të drejtat dhe kompensimet. Hetuesi interviston edhe kryesin, hap çështjen, përgatit raportin ditor, i cili do të procedohet më tej për provat statistikore, mban dosjen e provave në dosjet e brendshme të hetuesve në stacionet policore dhe e regjistron në bazën e përgjithshme të të dhënave.<sup>15</sup>

Hetuesi është përgjegjës edhe për koordinimin e të gjitha veprimeve hetimore me Prokurorin e Shtetit, për përgatitjen e “Kallëzimit Penal” dhe dorëzimin e tij në Prokurori sa më parë.

Mbrojtësi i viktimës obligohet që të kontaktoj/takoj urgjentisht viktimën pas njoftimit për rastin e dhunës në familje. Ai udhëzon viktimën për të drejtën e paraqitjes së kërkesës për urdhër mbrojtje, njëkohësisht në pajtim me të përgatit formën e urdhrit mbrojtës për aprovim në gjykatë. Gjithashtu duhet të njoftojë viktimën se ka të drejtë të paraqesë një kërkesë pronësore juridike ose kompensim për dëmet e pësuar nga kryesi i një akti të tillë; procedurat e divorcit, duke përfshirë procedurat e pajtimit të detyrueshëm dhe çështjet e kujdestarisë së fëmijëve.

Punonjësi Social i cili është në ndërrim në kohën kur ka ndodhur ngjarja, duhet të jetë i pranishëm në rastet kur ka fëmijë dhe persona të ndjeshëm të përfshirë ose të ndikuar nga incidenti. Qendra për Punë Sociale cakton një menaxher të rastit për të ndjekur rastin, ndërkohë që i lejon viktimës të përfundojë periudhën e reflektimit prej 48 orësh përpara se të marrë një deklaratë tjetër nga viktima dhe para se të hartojë planin individual në bashkëpunim me viktimën.<sup>16</sup>

## **Hapi i katërt – Reagimet post emergjente (Mbrojtje)**

Kujdestarët në strehimore luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e viktimës pas reagimit emergjent. Ata janë të detyruar të sigurojnë një strehë të sigurt për viktimat dhe të ofrojnë nevoja të tjera si: ushqim dhe veshmbathje. Menaxheri/psikologu ose kujdestari është i detyruar të këshillojë viktimën për trajtimin psikologjik, gjithashtu të sigurojë qasje në kujdesin shëndetësor dhe shërbime të tjera publike për vazhdimin e jetës.

Nga mbrojtësi i viktimës kërkohet që të jetë vazhdimisht në kontakt me viktimën dhe të jetë i pranishëm nëse nevojitet punë shtesë me prokurorët. Mbrojtësi i viktimave gjatë fazës së hetimit mund të kërkojë nga prokurori i shtetit marrjen ose ruajtjen e provave që mund të tregojnë dëmin e shkaktuar nga vepra penale. Mbrojtësi i viktimave mund të marrë pjesë në marrjen në pyetje në procedurat paraprake prokuroriale, duke paraqitur kërkesën e viktimës për vazhdimin e masës së ndalimit, nëse është e nevojshme.

Prokurori duhet të veprojë me urgjencë dhe prioritet, gjithmonë duke pasur parasysh specifikat e çështjes së dhunës në familje. Ai ka për detyrë të shqyrtojë provat e një incidenti të dhunës në familje

15 Procedurat e brendshme standarde dhe dokumenti i marrëveshjes ndërmjet institucioneve 2019

16 Procedura standarde e veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje e miratuar në vitin 2013 nga zyra e Qeverisë së Republikës së Kosovës

për të përcaktuar nëse ka prova të mjaftueshme për të justifikuar dhe mbështetur ndjekjen penale të çështjes. Kjo përfshin edhe vlerësimin për urdhrat mbrojtës / kufizues.<sup>17</sup>

## **Hapi i pestë - Vendimmarrja dhe procedurat e mëtutjeshme (Mbrojtje dhe rehabilitim)**

Gjykatësi gjithashtu duhet t'i trajtojë rastet e dhunës në familje me prioritet, pasi që Gjykata ka detyrim të marrë vendime brenda afateve ligjore. Gjykatësi merr vendimin për vështirësinë e çështjes (vepër civile ose penale), vendos për urdhrat mbrojtës/kufizues dhe punon për çështje të tjera të rastit.

Mbrojtësi i viktimës duhet të jetë gjithmonë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore. Urdhri i mbrojtjes është një urdhër që ofrohet si masë për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje me kërkesë të mbrojtësit të viktimës.

Menaxheri i çështjes sociale duhet të marrë pjesë edhe gjatë seancës gjyqësore në rast se ka përfshirje të fëmijëve. Menaxheri i rastit vlerëson gjendjen sociale dhe ekonomike të viktimave të dhunës në familje dhe është i detyruar të japë mendim për historikun familjar (anamnezën familjare), nëse është e nevojshme.<sup>18</sup>

## **Baza e përbashkët e të dhënave**

Ministria e Drejtësisë është pronare e bazës së të dhënave për dhunë në familje. Baza e të dhënave është ndërtuar, mirëmbajtur dhe mbikëqyret nga Ministria. Akterët që duhet të bashkëpunojnë për ta bërë këtë DB funksionale janë: Policia, Mbrojtësi i Viktimave, Prokuroria dhe Gjykata, Qendra për Punë Sociale dhe Strehimoret.

DBN duhet të regjistrohet dhe plotësohet me të dhënat nga të gjithë këta akterë që të mund të siguroj saktësinë dhe plotësinë e të dhënave.<sup>19</sup>

- *DBN është një sistem i vlefshëm i regjistrimit për të gjitha rastet e dhunës në familje në Kosovë. Kjo data bazë është themeluar vetëm për regjistrimin e këtyre rasteve dhe nuk përfshin raste të natyrave tjera.*
- *DBN përshkruan informata valide për çdo dosje siç janë: emri, data, adresa, përshkrimi i dhunës, raporti familjar si dhe të dhëna të tjera për viktimën dhe për*

17 Procedura standarde e veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje e miratuar në vitin 2013 nga zyra e Qeverisë së Republikës së Kosovës

18 Procedura standarde e veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje e miratuar në vitin 2013 nga zyra e Qeverisë së Republikës së Kosovës

19 Ministria e Drejtësisë, Marrëveshja për funksionalizimin e data bazës së përbashkët, 2019

kryesin e veprës. DBN duhet të përmbaj edhe vendimmarrjet lidhur me rastet e trajtuara nga ana e organeve të drejtësisë.

- Në DBN, policia regjistron çdo rast të raportuar dhe i referon ato tek institucionet tjera përgjegjëse të cilat po ashtu duhet ti regjistrojnë të dhënat në module të veçanta sipas domenit të tyre të trajtimit.
- Ministria e Drejtësisë përmes kësaj data baze koordinon dhe menaxhon të gjitha rastet e dhunës në familje, si dhe planifikon ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore në nivel shtetëror. Me regjistrimet e plota të të dhënave nga çdo institucion duhet të jetë në gjendje të ofroj raporte statistikore, raporte të gjendjes së strehimoreve dhe qendrës për punë sociale. Gjithashtu, qëllimi i kësaj data baze është që institucionet përgjegjëse të shkëmbejnë informatat, ti referojnë dhe ti trajtojnë rastet me kohë.<sup>20</sup>

Më poshtë shpalosim të gjitha gjetjet e auditimit, duke u bazuar në hapat e rrjedhjes së procesit.

### 3.1. Linja telefonike për thirrje emergjente

*Ndër aktivitetet e para reaguese pas incidentit është pranimi i thirrjeve telefonike nga qendra operative e stacioneve policore, e cila duhet të ketë qasje 24/7.<sup>21</sup>*

Aktivitetet e qendrës operative për pranimin e thirrjeve realizohen si në vijim; thirrja pranohet nga dispeçerët dhe më pas informacioni i përcillet menaxherit të ndërrimit për të njoftuar patrullën e policisë më afër vendit të ngjarjes. Zakonisht, thirrjet regjistrohen në regjistrin operativ. Sipas vëzhgimeve, marrja e informacionit për të nisur operacionin policor, bëhet në mënyrë të plotë, nga adresa ky zhvillohet ngjarja, numri i personave të përfshirë në incident, rrezikun që kanoset, përdorimi i mjeteve gjatë ushtrimit të dhunës etj. Dispeçeri aq sa është e mundur përmes linjës telefonike jep udhëzime se si të veprojnë deri sa të mbërrin në vend ngjarje patrulla e policisë. Sipas sqarimeve gjatë këtij vëzhgimi patrulla e policisë është e obliguar të mbërrin në vendin e ngjarjes pa marrë parasysh se si interpretohet gjithë situata nga telefonuesi. Operatori dhe dhoma e pritjes së thirrjeve ka tre zyrtarë të cilët punojnë 24 orë në ditë. Dispeçerët zëvendësojnë njëri-tjetrin duke ndryshuar ndërrimet çdo 12 orë.

Nga dokumentet e shqyrtuara kemi arritur në përfundim se reagimi i qendrës së thirrjes bëhet në mënyrë efikase. Po ashtu edhe në bazë të anketës së zhvilluar, të anketuarat pohojnë se reagimi i policisë në thirrjen telefonike ka qenë i menjëhershëm.

Pranimi i thirrjeve dhe përcjellja e informatës dhe të gjitha aktivitetet që realizohen në kuadër të kësaj qendre, ofrojnë mundësinë që trajtimi i rasteve të dhunës në familje të fillojë me kohë.

<sup>20</sup> Manuali i data bazës, si dhe strategjia për dhunë në familje

<sup>21</sup> Manuali i trajnimit të stacioneve policore "Trajnimet e DHF për policët e stacioneve policore"

## 3.2. Intervenimi i patrullës policore

*Patrulla e policisë është e detyruar të ndërhyjë menjëherë për të siguruar mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, si dhe të ndalojë kryesin e supozuar me qëllim të parandalimit të dhunës së mëtutjeshme. Koha e intervenimit përfshin periudhën nga koha e nisjes së ekipit policorë, arritjes në vendin e ngjarjes, vlerësimit të situatës, sigurimit të provave, lajmërimit të ekipeve hetuese apo mjekësore dhe dërgimit të viktimës në stacionin policorë.<sup>22</sup>*

Sipas dokumenteve të analizuara gjatë auditimit, intervenimet nga ana patrullës policore bëhen në kohë optimale.

Në raport me viktimën në stacionet policore në Prishtinë dhe Pejë është konfirmuar se intervenimi i policisë ndodh 15 - 30 minuta pasi të raportohet incidenti, kurse tërë procedura e trajtimit deri në përcjelljen e rastit në institucionet tjera kryhet brenda pesë (5) orëve.

Vlen të ceket se kemi konfirmuar se procedurat e trajtimit në stacionet policore, për shkak të komplikimit të rastit, mund të zgjasin rreth 12 orë.<sup>23</sup> (Shtojca 2, Tabela 1).

Në ndërkohë, patrulla policore sigurohet që viktima patjetër të marrë shërbimet e nevojshme shëndetësore dhe të dërgohet në stacionin policor për dhënien e deklaratës.

Sipas anketës së zhvilluar intervenimi i patrullës policore zakonisht bëhet me kohë, të anketuarat nuk kanë pasur vërejtje me intervenimet e patrullës policore.

Reagimi në kohë dhe efikas i policisë lejon marrjen e masave të menjëhershme, ndërprerjen e dhunës, sigurimin e viktimës dhe të provave.

22 Procedura standarde e veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje e miratuar në vitin 2013 nga zyra e Qeverisë së Republikës së Kosovës, pika 3.1.1

23 Shtojca nr 1 Analiza e efikasitetit të reagimit të policisë, SP, Prishtinë, Pejë

### 3.3. Marrja e deklaratave të para nga pjesëmarrësit në konflikt

Në këtë kapitull, janë përfshirë gjetjet që kanë të bëjnë me fazën e mbrojtjes së viktimës lidhur me angazhimin e hetuesve policor, monitorimin e urdhrave mbrojtjes, vlerësimin fillestar të rrezikut dhe regjistrimet e rasteve nga stacionet policore.

- *Angazhimi i hetuesve edhe në rastet tjera jashtë natyrës së dhunës në familje*

*Hetimi i rasteve të dhunës në familje bëhet nga ana e hetuesve policor.<sup>24</sup> Hetuesit primar të dhunës në familje, duhet të merren ekskluzivisht me rastet e dhunës në familje dhe nuk mund të ngarkohen me raste të tjera.<sup>25</sup>*

Në Prishtinë, hetuesit e rasteve të dhunës në familje funksionojnë në kuadër të tre stacioneve policore, si dhe në njësinë rajonale të hetimeve. Në tre stacionet policore dhe në njësinë rajonale të hetimeve, gjatë vitit 2020 kanë qenë të angazhuar nëntë (9) hetues, në vitin 2021 dhjetë (10), ndërsa në vitin 2022 kanë qenë të angazhuar pesëmbëdhjetë (15) hetues.


Në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përgjegjësinë kryesore e mbajnë hetuesit primar në stacionet policore të cilët duhet të merren ekskluzivisht vetëm me trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Mirëpo, hetuesit primar përveç rasteve të dhunës në familje angazhohen në trajtimin e një numri të konsiderueshëm të rasteve jashtë natyrës së dhunës në familje. Numrin e rasteve të dhunës në familje të trajtuara nga ana e hetuesve primar si dhe veprave tjera penale kemi paraqitur në grafikun në vijim.

<sup>24</sup> Procedurat Standarde të Operimit, Policia e Kosovës 2011, fq.6 pika 6

<sup>25</sup> Procedurat Standarde të Operimit, Për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje, Policia e Kosovës, 2022 fq.7 pika 5, e, g. - Në stacionet e kategorive A, duhet të caktohen 4 zyrtarë policor hetues, në stacionet e kategorive B, duhet të caktohen 3 zyrtarë policor hetues, ndërsa në stacionet e kategorisë C nga dy zyrtarë policor. Njëri prej të cilëve duhet të jetë i zgjedhur si hetues primar i dhunës në familje.

**Grafiku 2. Trajtimi i rasteve të dhunës në familje si dhe veprave tjera penale nga ana e hetuesve primar**

**Angazhimi i hetuesve primar në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe veprave të tjera penale, 2020-2022 - Prishtinë**




Siç shihet në grafik, një pjesë e konsiderueshme e punës së hetuesve policor në Prishtinë ka të bëjë me rastet të cilat nuk janë të dhunës në familje. Kjo mund të ndikoj që puna e tyre lidhur me rastet e dhunës në familje të limitohet, kështu që viktimat mund të mos i marrin të gjitha shërbimet e nevojshme dhe të mos trajtohen me profesionalizëm dhe sipas ndjeshmërisë së rastit.

Në Pejë, hetuesit e rasteve të dhunës në familje funksionojnë në kuadër të stacionit policor si dhe në njësinë rajonale të hetimeve. Gjatë periudhës 2020-2022 në stacionin policor dhe në njësinë rajonale të hetimeve kanë qenë të angazhuar 5 hetues të dhunës në familje.

Angazhimi i hetuesve primar në trajtimin edhe të rasteve tjera penale ndodh edhe në SP Pejë. Numrin e rasteve të dhunës në familje të trajtuara nga ana e hetuesve primar si dhe veprave tjera penale të trajtuara nga ana e tyre kemi paraqitur në grafikun në vijim.

**Grafiku 3. Trajtimi i rasteve të dhunës në familje si dhe veprave tjera penale nga ana e hetuesve primar**

**Angazhimi i hetuesve primar në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe veprave të tjera penale, 2020-2022 - Pejë**



Këtu mund të shihet se situata me hetuesit e dhunës në familje në stacionin policor në Pejë është madje më e përqesuar gjatë viteve 2020 dhe 2021 për shkak të volumit të madh të punës me trajtimin e rasteve jashtë dukurisë së dhunës në familje. Kjo mund të ndikoj që hetuesit policor të jenë të mbingarkuar edhe me trajtimin e rasteve të tjera gjë që shkakton që viktimat mund të mos të trajtohen në mënyrë adekuate. (Shtojca 2, Tabela 2).

Lidhur me trajtimin nga hetuesit, 4 nga 40 gra të anketuara kanë ngritur si shqetësim çështjen se gjatë dhënies së deklaratës hetuesi policor nuk ishte i paanshëm dhe në një rast viktimës i është imponuar dhënia e deklaratës në prezencë të fëmijës.

Angazhimi i hetuesve primar në hetimin edhe të rasteve të tjera të cilat nuk janë të natyrës së dhunës në familje, ka ndodhur në mungesë të numrit të mjaftueshëm të hetuesve si dhe për shfrytëzimin e kapaciteteve që kanë në dispozicion. Mirëpo, angazhimi i hetuesve primar të dhunës në familje në hetimin edhe të rasteve të tjera, mund të ndikoj që trajtimi i rasteve të dhunës në familje, të bëhet nga hetues të tjerë të cilët nuk janë të trajnuar për këtë qëllim, nuk kanë ekspertizë, aftësi dhe kompetencë



për zgjidhjen e rasteve serioze. Njëkohësisht kjo ka ndikuar që hetuesit të mos arrijnë ti regjistrojnë të gjitha rastet në sistem, e që viktimës mund të mos i ofrohen shërbimet dhe trajtimi adekuat me kohë.

### • *Zbatimi i urdhrave mbrojtës pa procedura standarde*

*Sipas Procedurave të Përgjithshme Standarde të Veprimit, Policia është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të urdhrave mbrojtës të lëshuar nga gjykata, si dhe të urdhrave mbrojtës emergjent të lëshuar nga Policia, në rastet kur dhuna ndodh gjatë ditëve të vikendit dhe jashtë orarit të rregullt të punës së gjykatave.<sup>26</sup>*

Kemi vërejtur se Policia nuk ka pas ndonjë rregullore apo procedurë të tyre të brendshme për monitorimin e urdhrave mbrojtës. Megjithatë, gjatë periudhës 2020-2022 ky monitorim është bërë sipas kërkesës së viktimës.

Drejtoria e përgjithshme e Policisë e ka identifikuar këtë problem dhe në fillim të vitit 2023 ka plotësuar politikat e tyre me hartimin e standardeve të veprimit për ekzekutimin e urdhrave mbrojtës. Kjo procedurë përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e hetuesve të dhunës në familje si dhe zyrtarëve tjerë policor.<sup>27</sup> Po ashtu, përmes kësaj procedure rregullohen format e ndërveprimit me palët tjera në njoftim dhe reagim.

Mungesa e rregullave dhe procedurave të qarta për monitorimin e urdhrave të mbrojtjes mund të ketë kontribuar që viktimat të mos marr mbrojtjen e duhur në kohë. Mungesa e udhëzimeve se sa shpesh duhen vizituar apo kontrolluar viktimat do të thotë se siguria e tyre mund të rrezikohet. Po ashtu, monitorimi i urdhrave të mbrojtjes me kërkesë të viktimës nënkupton mungesën e ndjekjes sistematike. Kjo mund të shkaktoj vonesa në reagimin ndaj shkeljeve të urdhrave mbrojtës duke i vënë viktimat në rrezik.

### • *Në stacionet policore bëhet një vlerësim fillestar i rrezikut*

*Vlerësimi i rrezikut është procesi përmes të cilit vlerësohet niveli i rrezikut që i kanoset viktimës. Pas pranimit të informacioneve fillestare, Policia bën vlerësimin e rrezikut për viktimën e dhunës në familje.<sup>28</sup>*

Gjatë marrjes së deklaratës nga ana e viktimës, hetuesit në stacionet policore bëjnë vlerësimin e rrezikut. Vlerësimi i rrezikut për rastet e regjistruara bëhet në tri kategori: të ultë, të mesëm dhe të lartë.

Në stacionet policore të Prishtinës është bërë një vlerësim i përgjithshëm i rrezikut rreth 75% të rasteve, ndërsa në stacionin policor të Pejës, ky vlerësim është bërë në mbi 87% të rasteve.

<sup>26</sup> Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në Kosovës, fq.37

<sup>27</sup> Procedurat standarde të veprimit për ekzekutim të urdhrave mbrojtës, janar 2023

<sup>28</sup> Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në Kosovës, fq.37

Policia e Prishtinës gjatë periudhës 2020-2022, rreth 21-31% të rasteve i ka vlerësuar me rrezikshmëri të ultë, rreth 66-75% me rrezikshmëri të mesme, dhe 0-2.8 % me rrezikshmëri të lartë. Kurse, Policia e Pejës për periudhën e njëjtë, rreth 10-87% të rasteve i ka vlerësuar me rrezikshmëri të ultë, 13-66% me rrezikshmëri të mesme dhe 0- 21% me rrezikshmëri të lartë.

**Tabela 1. Vlerësimi i nivelit të rrezikshmërisë**

| Stacionet Policore | Vlerësimi i nivelit të rrezikshmërisë |      |       |       |                     |      |       |       |                     |      |       |       |
|--------------------|---------------------------------------|------|-------|-------|---------------------|------|-------|-------|---------------------|------|-------|-------|
|                    | 2020                                  |      |       |       | 2021                |      |       |       | 2022                |      |       |       |
|                    | Nr. total i rasteve                   | ulët | mesëm | lartë | Nr. total i rasteve | ulët | mesëm | lartë | Nr. total i rasteve | ulët | mesëm | lartë |
| Prishtinë          | 330                                   | 68   | 247   | 0     | 404                 | 93   | 301   | 6     | 458                 | 143  | 302   | 13    |
| Pejë               | 166                                   | 145  | 21    | 0     | 184                 | 113  | 63    | 1     | 220                 | 22   | 144   | 46    |

Ky vlerësim i rrezikut që bëhet nga ana e Policisë jep një pasqyrë për nivelin e dhunës fizike, rrezikun e situatës, potencialit të dhunës dhe sigurimin e provave. Mirëpo, ky vlerësim duhet të rishikohet më tutje, sepse stacionet policore nuk kanë ekspertizë dhe as kapacitete për ta vlerësuar rrezikun real. Këtë e tregon edhe mos vlerësim i asnjë rasti me rrezikshmëri të lartë gjatë vitit 2020 apo edhe me një përqindje të ultë gjatë viteve 2021-2022. Megjithatë, ky vlerësim ka për qëllim që të jep informatat bazike për institucionet tjera përgjegjëse lidhur me incidentin dhe pasojat e tij.

### • Dobësi gjatë regjistrimit të rasteve nga Stacionet Policore

*Pasqyrimi i gjendjes së përgjithshme të dhunës në familje duhet të bëhet përmes përgatitjes së raporteve dhe pasqyrimin të informatave nga të gjitha institucionet përgjegjëse.<sup>29</sup>*

Procesi i regjistrimit fillon në stacionet policore ku nga hetuesi policor bëhet regjistrimi fillestar gjatë pranimit të rastit dhe përpilohet raporti i shpejtë (formulari individual) i cili dërgohet në Drejtorinë Rajonale. Drejtorja rajonale përgatit raporte statistikore të cilat duhet të përputhen me raportet përmbledhëse të përgatitura në nivel stacionesh. Mirëpo ne kemi vërejtur se gjatë këtij procesi të regjistrimit numri i rasteve të raportuara nga Stacionet Policore nuk është në përputhje me numrin e rasteve të përfshira në raportin e Drejtorive Rajonale<sup>30</sup>.

Në Stacionet Policore të Prishtinës kjo diferencë dhe mospërputhje për vitin 2020 arrin në 28 raste, në vitin 2021 dallimi është 7 raste, kurse në vitin 2022 mospërputhja është 22 raste. Në stacionin policorë të Pejës mospërputhja për vitin 2020 dallon për 3 raste, në vitin 2021 për 41 raste, ndërsa në vitin 2022 te dhënat mes raporteve kanë qenë të sakta.


29 Strategjia për mbrojtjen kundër dhunës në familje 2022-26 Objektiva strategjike III, Fuqizimi i institucioneve për trajtim të viktimave, fq. 45, Indikatorit SGD 16.3.1

30 Raportet për regjistrimet në data bazën interne


Një pasqyrë krahasuese e të dhënave mes informatave nga Stacionet Policore me Drejtorinë Rajonale është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

**Grafiku 4. Regjistrimi i rasteve në stacionet policore**

**Komuna e Prishtinës**



**Komuna e Pejës**



Njëra nga arsyet e mos përrputhjes së të dhënave në regjistrim sipas zyrtarëve në SP të Prishtinës mund të jetë për shkaqe administrative, apo për arsye të dyfishimit të veprave për të njëjtat raste. Si pasojë e kësaj rastet e regjistruara mund të paraqiten si të dyfishuara në raportet statistikore.<sup>31</sup> Kurse, sipas zyrtarëve përgjegjës të SP Pejës, numri i vogël i hetuesve në proporcion me numrin e rasteve ka ndikuar që procesi të përcillet me parregullsi në regjistrim.

Mospërrputhjet në regjistrimin e të dhënave mund të rrezikoj proceset e vendimmarrjes duke penguar shpërndarjen efektive të burimeve dhe mungesën e prioritizimit të rasteve. Informatat jo të plota për të gjitha rastet e regjistruara ndikojnë gjithashtu në pasqyrimin e pasaktë të gjendjes së përgjithshme në data bazën e Ministrisë së Drejtësisë.

- *Policia nuk po arrin ta përcjell informatën tek mbrojtësit e viktimave për çdo rast të raportuar*

*Institucionet përgjegjëse duhet të kenë komunikim dhe bashkëpunim mes vete dhe të shkëmbejnë informatat në mënyrë gjithëpërfshirëse/të plota. Kategoritë e trajtimit të rasteve të dhunës në familje në praktikë nuk janë plotësisht të ndara por janë të ndërrvarura me njëra tjetrën dhe paraqiten në vazhdimësi gjatë gjithë procesit.<sup>32</sup>*

Sipas zyrtarëve policor<sup>33</sup> informatat për çdo rast të raportuar të dhunës në familje përcillen edhe tek ZMNV, mirëpo sipas të dhënave të ofruara statistikore kemi vërejtur se mbrojtësit e viktimave nuk po informohen për të gjitha rastet e paraqitura të dhunës në familje.<sup>34</sup>

Nga numri i përgjithshëm i rasteve të dhunës në familje në Stacionet Policore të Prishtinës gjatë vitit 2020, mbrojtësit e viktimave janë informuar në 58% të rasteve, kurse në vitin 2021 në 69% të rasteve.

Në Stacionin Policor të Pejës informimi i mbrojtësve të viktimave gjatë vitit 2020 është bërë në 100% të rasteve kurse gjatë vitit 2021 në 60% të rasteve. Mirëpo Stacionet Policore të Prishtinës dhe Pejës për vitin 2022 nuk kanë evidenca lidhur me përqindjen e rasteve për të cilat janë njoftuar mbrojtësit e viktimave.

31 Intervista me zyrtarët e stacionit policor Prishtinë

32 PSV 2013, Fazat e procedurave standard të veprimit gjatë reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje

33 Intervista e mbajtur me Mbikqyrësin e Njesisë për dhunë në familje në Pejë, si dhe me mbikqyrësin e Njesisë për dhunë në familje në Prishtinë

34 Raportet vjetore statistikore për periudhën 2020-2022, Policia e Prishtinës dhe e Pejës në nivel lokal

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur, numrin e rasteve të dhunës në familje në krahasim me numrin e rasteve kur janë njoftuar mbrojtësit e viktimave.

**Tabela 2. Numri i rasteve të raportuara/përcjellja e informatës në ZMNV nga Stacionet Policore në Prishtinë dhe Pejë**

|      |                             | Stacionet Policore Prishtinë | Stacioni Policor Pejë |
|------|-----------------------------|------------------------------|-----------------------|
| 2020 | Nr. i rasteve të raportuara | 328                          | 165                   |
|      | Nr. i njoftimeve të MV      | 191                          | 165                   |
| 2021 | Nr. i rasteve të raportuara | 412                          | 181                   |
|      | Nr. i njoftimeve të MV      | 275                          | 108                   |
| 2022 | Nr. i rasteve të raportuara | 457                          | 218                   |
|      | Nr. i njoftimeve të MV      | N/A                          | N/A                   |

Burimi: Raportet statistikore vjetore, Policia e Prishtinës dhe e Pejës – niveli lokal

Kjo do të thotë se ka raste kur ZMNV në Prishtinë nuk ka pas fare informata për rastin. Arsyeimi i zyrtarëve policor për mungesën e informatave ka qenë se ata kanë bërë këtë përmes telefonit, gjë e cila nuk ka mundur të konfirmohet.

Ndërsa në ZMNV e Pejës, edhe pse ka pasur evidenca të përgjithshme për rastin, kontaktimin me viktimën ka qenë i pamundur sepse dokumentacioni nuk ka përmbajtur të dhëna të plota për të kontaktuar me viktimën.<sup>35</sup>

Nga anketa e zhvilluar, 10 veta kanë pasur pakënaqësi me reagimin e mbrojtësve të viktimave, vërejtjet e tyre kanë të bëjnë me: vonesat e kontaktimit dhe shpesh herë kontaktin e parë me mbrojtësin e viktimave e kanë pasur vetëm pasi kanë shkuar në seanca gjyqësore.

Mungesa e komunikimit dhe informacioni jo i plotë ndikon që ZMNV-të të mos jenë të informuar për të gjitha rastet e dhunës duke krijuar vështirësi në mbështetjen e viktimave dhe kontaktin me ta.

35 Intervista e mbajtur me udhëheqësin e Zyrës për mbrojtje dhe ndihmë viktimave Pejë

- *Mos përcaktimi i punëtorëve social vetëm për trajtimin e rasteve të dhunës në familje*

*Qendrat për punë sociale (QPS), merren me trajtimin e rasteve të dhunës në familje atëherë kur viktimat ka nevojë për mbështetje sociale dhe familjare si dhe në rastet kur fëmijët nën moshën 18 vjeçare kanë qenë prezent gjatë dhunës në familje qoftë si viktimë apo si dëshmitarë<sup>36</sup>.*

QPS-të në dy komunat, trajtojnë rastet e dhunës brenda një afati optimal të kohës në aspektin e ofrimit të shërbimeve sociale, kurse sesionet psikologjike ofrohen pas 48 orëve të vendosjes së viktimës në strehimore. Një pasqyrë e plotë e aktiviteteve, llojet e shërbimeve të ofruara si dhe kohëzgjatjen e trajtimit të rasteve nga ana e QPS-ve, është paraqitur në shtojcën 2 (Tabela 4).

Është vërejtur se në QPS-Prishtinë, nuk ka ndarje të detyrave mes punëtorëve social të cilët do duhej të merren vetëm me trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Të gjithë punëtorët merren me trajtimin edhe të rasteve tjera, përfshirë edhe ato si: kontaktimi mes prindërve dhe fëmijëve, divorcet, delikuenca tek të miturit, besimi i fëmijëve, përshtatshmëria për adoptim, këshilla martesore dhe keqtrajtimi i fëmijëve. Përveç rasteve të natyrave të ndryshme, me trajtimin e rasteve të dhunës në familje merren 15 zyrtarë/menaxher të rasteve, të cilët janë staf i rregullt i QPS-së, si dhe 9 zyrtarë të tjerë të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta.

Në QPS-Pejë, deri në fund të vitit 2020 me trajtimin e rasteve të dhunës në familje ka qenë i angazhuar vetëm një punëtorë social i cili është marrë vetëm me rastet e dhunës në familje. Kurse, gjatë viteve 2021-2022 trajtimi i rasteve të dhunës në familje bëhet nga 4 zyrtarë/menaxher të rasteve dhe ndarja e rasteve bëhet sipas radhës.

Numri i rasteve të dhunës që kanë kërkuar ndihmën dhe janë trajtuar nga ana e QPS-ve, në Prishtinë dhe Pejë është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 3. Numri i rasteve të dhunës të trajtuar nga ana e QPS-ve<sup>37</sup>**

| Qendrat për Punë Sociale |           |      |
|--------------------------|-----------|------|
| Viti                     | Prishtinë | Pejë |
| 2020                     | 147       | 31   |
| 2021                     | 203       | 36   |
| 2022                     | 330       | 66   |

Burimi: Raportet vjetore 2020-2022

Nga tabela vërehet se numri i rasteve të dhunës të cilat trajtohen nga ana e QPS-ve, ka shënuar rritje në dy vitet e fundit. Në QPS-në e Prishtinës, numri i rasteve të dhunës është rritur rreth 62%, ndërsa në

<sup>36</sup> Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, ABGJ 2013

<sup>37</sup> Të dhënat e marra nga raportet vjetore të QPS-së Prishtinë, Pejë

QPS-në e Pejës është rritur 55%. Ky nivel i rritjes së vazhdueshme të rasteve kërkon një ndarje më të mirë të detyrave në mes të punëtorëve social.

Sipas autoriteteve, mos përcaktimi i punëtorëve social të cilët do të merreshin vetëm me rastet e dhunës në familje ka ndodhur për shkak të volumit të madh të punës në QPS. Mirëpo punëtorët e angazhuar në QPS janë të certifikuar si punëtor social dhe nuk janë të profilizuar vetëm për fushat konkrete. Gjithashtu, trajnimet që zhvillohen për stafin e punësuar bëhen të gjithë, pa dallim në aspektin e angazhimeve.<sup>38</sup>

Nga anketa e zhvilluar 12 veta kanë deklaruar se janë të pakënaqura me shërbimet sociale. Pakënaqësitë e tyre kanë të bëjnë: me kontaktin me punëtorin social, mungesa e paanshmërisë, ndërrimin e menaxherit të rastit.

Mungesa e përcaktimit të punëtorëve social vetëm për trajtimin e rasteve të dhunës në familje mund të ndikoj në shërbimet e ofruara nga ana e tyre. Punëtorët social të cilët nuk janë të trajnuar për këtë qëllim, nuk kanë ekspertizë, aftësi dhe kompetencë për zgjidhjen e rasteve të dhunës në familje.

Kjo duke marrë parasysh se dhuna në familje është dukuri e ndjeshme dhe punëtorët social duhet të jenë kompetent dhe të përgatitur për trajtimin specifik të tyre.

### 3.4. Reagimet post-urgjente

Në këtë kapitull, janë përfshirë gjetjet që kanë të bëjnë me mungesën e mbështetjes së strehimoreve, mos përfshirjen e mbrojtësit të viktimave gjatë gjithë procesit të trajtimit si dhe shqyrtimi i rasteve nga prokuroria.

- *Mungesë e përkrahjes institucionale për viktimat e vendosura në strehimore*

*Strehimoret janë të obliguara që të sigurojnë kushtet bazike, trajtimin e shëndetit fizik dhe psikologjik dhe të ofrojnë shërbime të sigurisë.<sup>39</sup>*

Se sa arrijnë strehimoret që të realizojnë shërbimet e parapara me ligj dhe ato që parashtrohen nga rrethanat dhe nevojat e ndihmë kërkuesve, ne kemi paraqitur një pasqyrë të gjendjes për dy prej strehimoreve të cilat janë duke funksionuar në Prishtinë dhe Pejë. Edhe pse këto dy strehimore janë të vendosura në nivel lokal, aty vendosen rastet që vijnë edhe nga komunat tjera, prandaj të dhënat e shpalosura më poshtë i takojnë nivelit regional.

<sup>38</sup> Intervistat e zhvilluara me zyrtarët e QPS Prishtinë, Pejë.

<sup>39</sup> Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, ABGJ 2013

Në strehimoren në Prishtinë gjatë periudhë 2020-2022 janë strehuar 121-174 veta. Vlen të ceket se në këtë strehimore gjatë kësaj periudhe kohore kanë kaluar një numër prej 195 të miturve.

Në strehimoren në Pejë gjatë periudhës 2020-2022 janë strehuar 96-120 veta. Edhe në këtë strehimore kanë kaluar një numër prej 131 të mitur.

Të gjitha të anketuarat janë të kënaqura me trajtimin e tyre nga menaxhmenti dhe stafi i strehimoreve.

Bashkëpunimi me institucionet tjera përgjegjëse në nivel regjional ka vështirësitë e veta. Ka raste kur policia për shkaqe të panjohura nuk i përgjigjen thirrjeve të strehimores për të përcjellë viktimat në seancat gjyqësore apo në vendet ku ato duhet të paraqiten përderisa janë të strehuara aty. QPS-të nuk i caktojnë menaxherët e rasteve me kohë dhe përpilimi i planeve specifike nuk shqyrtohet në bashkëpunim me viktimën dhe strehimoren.

- *Dobësi në përfshirjen e mbrojtësve të viktimave gjatë gjithë procesit të trajtimit*

*Mbrojtësit e viktimave duhet ta kontaktojnë viktimën dhe ta njoftojnë atë për të drejtat që i ka, asistojnë në marrjen e shërbimeve ligjore, ofrojnë këshilla për fillimin e procesit për urdhrat mbrojtës. Mbrojtësit e Viktimave kanë për obligim mbështetjen e pandërprerë të viktimës gjatë gjithë procesit gjyqësor<sup>40</sup>.*

Edhe pse mbrojtësit e viktimave zakonisht përfaqësojnë dhe mbrojnë të drejtat e viktimës, sipas të dhënave ata nuk arrijnë të kontaktojnë viktimën brenda një kohe të shkurtër. Është vërejtur se përfaqësimi i viktimave nga ana e tyre në të shumtën e rasteve bëhet pas marrjes së ftesës nga ana e gjykatës dhe se vetëm në raste të rralla kontakti me viktimat është bërë brenda 2-15 ditësh<sup>41</sup>. Kontakti me viktimën pas paraqitjes së rastit në polici zakonisht është arritur atëherë kur viktimat ka kërkuar ndihmën e Mbrojtësit të Viktimës<sup>42</sup>.

Në këtë aspekt, për dallim nga Regjioni i Prishtinës, në Regjionin e Pejës kemi hasur një qasje më të efektshme të kontaktimit të viktimës para seancave gjyqësore, dhe një interesim më të madh në aspektin e konfirmimit të deklaratimit të viktimave. Për më shumë detaje mund ti referojeni analizës së bashkëngjitur <sup>43</sup>(Shtojca 2, tabela 3).

Kërkesa për urdhër mbrojtje përgatitet nga ana mbrojtësit të viktimave në bashkëpunim me viktimën, më tutje kjo kërkesë inicion aprovimin e urdhrit mbrojtës nga gjykata.

40 Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, ABGJ 2013

41 Përfaqësimi i rasteve në seancat gjyqësore

42 Intervistimi i zyrtarëve në ZMNv në Prishtinë dhe Pejë

43 Prezanca e zyrtarëve të mbrojtjes në procesin e trajtimit të rasteve, shtojca 2 tabela 3



Numri i kërkesave për urdhër mbrojtje të përgatitur nga ana e mbrojtësve të viktimave është paraqitur më poshtë.

**Tabela 4. Krahasimi i numrit të rasteve të trajtuara nga ana e ZMNV-së, me numrin e kërkesave për urdhër mbrojtje**

| ZMNV - Prishtinë |             |                              |                               |                                |
|------------------|-------------|------------------------------|-------------------------------|--------------------------------|
| Viti             | Total raste | Kërkesa për UM <sup>44</sup> | Kërkesa për UME <sup>45</sup> | Kërkesa për UMPE <sup>46</sup> |
| 2020             | 313         | 161                          | 21                            | /                              |
| 2021             | 383         | 114                          | 30                            | 2                              |
| 2022             | 854         | 391                          | 52                            | 25                             |
| ZMNV – Pejë      |             |                              |                               |                                |
| Viti             | Total raste | Kërkesa për UM               | Kërkesa për UME               | Kërkesa për UMPE               |
| 2020             | 219         | 163                          |                               | /                              |
| 2021             | 261         | 116                          | 1                             | /                              |
| 2022             | 278         | 131                          | 1                             | 3                              |

Burimi: raportet vjetore nga ZMNV

Nga tabela mund të vërehet se jo të gjitha rastet e trajtuara nga ana e mbrojtësve të viktimave kanë kërkuar që të kenë urdhër mbrojtje. Kjo tregon se inicimi i urdhrave mbrojtje po bëhet vetëm për 50% të rasteve. Marrë parasysh se mbrojtësi i viktimave nuk është prezent në fillim të procesit të trajtimit mund të ndodhë që në raste të shpeshta urdhri mbrojtës nuk inicohet për shkak të mungesës së kontaktimit të menjëhershëm pas incidentit me viktimën.

Arsyeja pse mbrojtësit e viktimave nuk janë përfshirë në vazhdimësi që nga fillimi i lajmërimit të rastit ka ndodhur sepse mbrojtësit e viktimave veprojnë sipas një rregulloreje të lëshuar nga kryeprokurori. Kjo rregullore nuk i obligon ata që të jenë të pranishëm gjatë intervistave të para në polici dhe kjo zbrazëti ligjore i liron mbrojtësit e viktimave nga përgjegjësia e tyre për të kontaktuar viktimën në afat sa më të shkurtër kohorë pas raportimit të rastit. Vlen të ceket se sipas zyrtarëve, mungesa e mbrojtësit të viktimave në kohë të gjatë disa javore, ndodhë edhe për shkak të numrit të vogël të mbrojtësve të viktimave në krahasim me numrin në rritje të rasteve<sup>47</sup>.

44 Urdhër mbrojtje - urdhri i lëshuar me vendim gjykatë, 15 ditë pas parashtrimit të kërkesës, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën

45 Urdhër mbrojtje emergjente - urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykatë, 24 orë pas pranimit të kërkesës

46 Urdhër mbrojtje e përkohshme emergjente urdhri i lëshuar nga Policia, jashtë orarit të punës së gjykatave

47 Intervista e zhvilluar me ZMNV

Përkundër asaj se afati kohor i kontaktimit me viktimën është përcaktuar në procedurat e ZMNV-së, ku ceket se viktima duhet kontaktuar më së largu ditën e dytë pasi të jetë identifikuar, kjo procedurë nuk është zbatuar në praktikë.<sup>48</sup>

Në përgjigjet e marra nga anketa tregojnë se nëntë veta kanë deklaruar se nuk kanë qenë të kënaqura me mënyrën e marrjes në pyetje nga ana e mbrojtësit të viktimave. Ndërsa njëra ndër rastet ka deklaruar se nuk është informuar për të drejtën e kompensimit të dëmit derisa ka angazhuar një avokat privat.

Kjo situatë ndikon në humbjen e besimit mes mbrojtësit të viktimave dhe palës së dëmtuar, duke e bërë viktimën të ndihet e pa mbrojtur. Sidomos mund të ndikoj që rastet e lëndimeve të rënda dhe ato recidiviste të mbesin pa udhëzimet dhe këshillimet e nevojshme të cilat do të siguronin realizimin e kërkesave për të drejtat e tyre elementare dhe mbrojtjen nga rreziku që mund të ju kanoset.

### • *Shqyrtimi dhe përcjellja e rasteve nga Prokuroria Themelore*

*Prokurori pasi të njoftohet për rastin e dhunës në familje, duhet të veproj me urgjencë dhe prioritet gjithmonë duke pas parasysh specifikat e rastit të caktuar.<sup>49</sup>*

Vlerësimi i rrjedhës se procesit gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje nga ana e Prokurorisë është bërë vetëm nga të dhënat statistikore. Nga Prokuroria Themelore në Prishtinë këto të dhëna statistikore na janë ofruar rreth numrit të lëndëve të pranuara dhe shqyrtuara nga ana e tyre.

Në bazë të të dhënave statistikore, Prokuroria Themelore në Prishtinë në vitin 2020 ka arritur që ti shqyrtoj rreth 94% të rasteve të pranuara, në vitin 2021 i ka shqyrtuar rreth 81% të rasteve, kurse në vitin 2022 shqyrtimi i rasteve ka arritur deri në 96% të tyre.

Në përgjigjet e marra nga anketa tregojnë se shtatë nga dyzet të anketuarat kanë deklaruar se ka pas vonesa të kontaktimit të tyre nga ana e Prokurorisë. Njëra nga ato, ka theksuar se gjatë dhënies së deklaratës dhe ofrimit të dëshmive prokurori nuk ka ruajtur paanësinë, si dhe në një rast kur kryesi i dhunës është ndaluar për 48 orë dhe viktima nuk është njoftuar fare.

48 Procedurat standarde të operimit për ZMNV, Neni 5, Kontakti I pare, viti i hartimit 2013

49 Procedurat standarde të veprimtimit për mbrojtje nga dhunë në familje ABGJ 2013, fq.46

Në tabelën në vijim, kemi paraqitur numrin e lëndëve të pranuar dhe të shqyrtuara nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

**Tabela 5. Numri i rasteve të pranuar dhe të shqyrtuara**


|      | Total raste të pranuar | Total raste të shqyrtuara |
|------|------------------------|---------------------------|
| 2020 | 673                    | 635                       |
| 2021 | 837                    | 680                       |
| 2022 | 916                    | 877                       |

Burimi: Raportet statistikore Prokuroria Themelore Prishtinë

Prokuroria pas mbledhjes së dëshmive dhe sqarimeve të rrethanave, ndërmerr veprimet e saj përmes ngritjes së akteve të ndryshme varësisht prej nivelit të dhunës së shkaktuar dhe veprës penale, të cilat janë paraqitur në grafikun në vijim.

**Grafiku 5. Aktet e nxjerra nga Prokuroria Themelore në Prishtinë**

### Vendimet e ndërmarra nga prokuroria, 2020-2022




Burimi: raporte statistikore, Prokuroria Themelore Prishtinë

Në bazë të grafikut, vërejmë se Prokuroria Themelore në Prishtinë, gjatë periudhës 2020-2022 për rastet e dhunës në familje më tepër ka bërë aktakuzë të drejtpërdrejtë, pasuar pastaj me aktakuzë pas hetimit. Ndërsa numri i akteve për trajtim të detyrueshëm psikiatrik dhe cedim është më i vogël.

Ndërsa, sa i përket Prokurorisë Themelore në Pejë, sipas të dhënave statistikore, gjatë vitit 2020 janë pranuar 269 raste për vepër penale dhunë në familje, janë ngritur 243 aktakuza dhe 12 propozime për trajtim të detyrueshëm psikiatrik, janë hedhur 18 kallëzime penale për raste të dhunës në familje, gjersa kanë mbetur 12 lëndë të papërfunduara, të cilat janë bartur në vitin 2021.<sup>50</sup>

Në vitin 2021, raste të dhunës në familje kanë pranuar 314 kallëzime penale, ku gjithsej për atë vit duke marrë edhe 12 të bartura nga viti paraprak, ishin 326 raste. Prej këtyre rasteve janë përfunduar 313 dhe për vitin 2022 janë bartur 13 lëndë. Prej lëndëve të përfunduara janë ngritur 284 aktakuza, në 4 raste janë pushuar hetimet, në 19 raste është hedhur kallëzimi penal, në 5 raste është bërë propozimi për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe 1 rast është dërguar në kompetencë.<sup>51</sup>

**Grafiku 6. Mënyra e përfundimit të rasteve të dhunës në familje për vitin 2021**



Burimi: raporte statistikore, Prokuroria Themelore Pejë


<sup>50</sup> Te dhenat statistikore nga Prokuroria e Pejës

<sup>51</sup> Te dhenat statistikore nga Prokuroria e Pejës

Përqindja e kryerjes të rasteve të dhunës në familje gjatë vitit 2021 ka arritë në 96%.

**Grafiku 7. Përqindja e kryerjes së rasteve për vitin 2021**

**Përqindja e kryerjes të rasteve të dhunës në familje**



Burimi: raporte statistikore, Prokuroria Themelore Pejë

Për rastet e dhunës në familje gjatë vitit 2022 në Prokurorinë e Pejës janë bartur 13 lëndë nga vitet paraprake, janë pranuar 257 raste për veprë penale dhunë në familje, janë ngritur 208 aktakuza, 8 propozime për trajtim të detyrueshëm psikiatrik, dhe janë hedhur 12 kallëzime penale.<sup>52</sup>

<sup>52</sup> Te dhenat statistikore nga Prokuroria e Pejës

## 3.5. Vendimmarrja dhe procedurat e mëtutjeshme

Në këtë kapitull, janë përfshirë gjetjet që kanë të bëjnë me: mospërkrahjen e viktimave të vendosura në strehimore, mungesën e udhëzimeve nga mbrojtësit e viktimave, mungesën e shërbimeve të rehabilitimit në QPS si dhe mos trajtimin e të gjitha rasteve nga ana e gjykatave.

- *Përkrahja e pamjaftueshme institucionale për të vendosurit në strehimore*

*Strehimoret ofrojnë kujdes të vazhdueshëm shëndetësor, psikologjik dhe ndihmojnë të mbijetuarat e dhunës në familje që të rehabilitohen dhe të vazhdojnë jetën.*<sup>53</sup>

Është vërtetuar se për të trajtuar rastet e pranura në strehimore angazhohen psikologë për trajtimin e rasteve të cilët janë prezent dy deri tri herë gjatë javës.

Po ashtu, është vërtetuar se menaxherët e strehimores janë angazhuar në aspektin e rehabilitimit dhe inkuadrimit të të mbijetuarave duke lidhur marrëveshje me organizata të ndryshme të cilat ofrojnë kurse për aftësim profesional të profileve të ndryshme. Vlen të ceket se Ministria e e Financave, Punës dhe Transfereve gjatë vitit 2022, ka ofruar përkrahje financiare në vlerë prej 40,000 për projektin “Ofrimi i shërbimeve rezidenciale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në regionin e Pejës”.<sup>54</sup>

Po ashtu, në fund të vitit 2022 është aprovuar me vendim nga Qeveria, ndarja e mjeteve financiare në vlerë prej 500,000 euro për organizatat jo-qeveritare të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe Strehimore.<sup>55</sup>

Rezultatet e anketës konfirmojnë se të anketuarat janë të kënaqura me shërbimet e ofruara, si seancat psikologjike ashtu edhe të gjitha shërbimet tjera të ofruara nga strehimorja.

Megjithatë, njëra nga sfidat e pakalueshme mbetet punësimi dhe pavarësia financiare e të mbijetuarave të dhunës në familje. Kjo është cekur edhe në hulumtimin e bërë nga OSBE për vitet 2016-2019, ku theksohet se këto grupe të ndjeshme të shoqërisë nuk kanë hasur në përkrahje institucionale në aspektin financiar si kusht për rikthimin në normalitet.<sup>56</sup>

Në anën tjetër, shqetësimet e ngritura nga mbikëqyrësit e strehimoreve tregojnë se viktimat ballafaqohen me vonesat e seancave gjyqësore, faza e pritjes deri në seancën e parë gjyqësore është një përjetim tejet i vështirë për viktimën, aq më tepër nëse zgjatë me javë pas incidentit. Po ashtu ndikim të madh ka qasja e organeve të drejtësisë ndaj kërkesave për vazhdimin e urdhër mbrojtjeve që është edhe më i rëndësishëm kur viktimat vendosin të rikthehen jetës.

<sup>53</sup> Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhunë në familje ABGJ 2013

<sup>54</sup> Kontrata e projektit

<sup>55</sup> Vendimi 19/109 dates 23.11.2022

<sup>56</sup> Anketa për mireqenien e grave dhe vajzave, OSBE

Vonesat në seancat gjyqësore mund të pengojnë viktimën për të rindërtuar jetën e tyre dhe për të kaluar përvojën traumatike. Pasiguria dhe periudha e zgjatur e pritjes mund të ndikojë në rikuperimin e tyre dhe kërkimin e drejtësisë.

- *Mungesa e udhëzimeve nga mbrojtësi i viktimave gjatë fazës së rehabilitimit*

*Mbrojtësi i viktimës duhet të udhëzojë viktimën lidhur me procedurat mëtutjeshme, kompensimin e dëmit dhe masat tjera mbrojtëse.<sup>57</sup>*

Mbrojtësit e viktimave marrin pjesë në seancat gjyqësore dhe në hartimin e urdhrave mbrojtës, por problematikë mbetet iniciimi i procedurave për kompensimin e dëmit material. Kjo mund të ndodhë për shkakun se mbrojtësi i viktimave nuk është prezent gjatë fazave fillestare të trajtimit,<sup>58</sup> kur edhe nisin procedurat.

Në mungesë të informacionit, viktimat mund të kenë njohuri të kufizuar ose të pamjaftueshme lidhur me procesin e përfitimit të kompensimit material, ngritjen e kërkesave për dëmshpërblim dhe përballjen me vështirësi financiare.

- *Mungesë e shërbimeve të rehabilitimit të viktimave nga Qendrat për punë sociale*

*Qendrat për punë sociale (QPS), merren me trajtimin e rasteve të dhunës në familje atëherë kur viktimat ka nevojë për mbështetje sociale dhe familjare si dhe në rastet kur fëmijët nën moshën 18 vjeçare kanë qenë prezent gjatë dhunës në familje qoftë si viktimë apo si dëshmitarë.<sup>59</sup>*

Edhe përkundër ofrimit të shërbimeve të përgjithshme sociale nga ana e QPS-ve, kemi vërejtur se në këto qendra ka pasur mungesë të angazhimit të psikologëve. Në QPS Pejë është vetëm një psikolog-sociolog i cili ka qenë njëkohësisht angazhuar në cilësinë e udhëheqësit. Në QPS Prishtinë nuk ka pas psikologë të rregullt deri pas nëntorit të vitit 2022, mirëpo për ofrimin e shërbimeve të tilla kanë angazhuar psikologë të jashtëm sipas nevojës<sup>60</sup>.

Një mungesë tjetër është edhe ofrimi i shërbimeve sociale për kryesit e veprave për periudhën 2019-2022. Një program i trajtimit dhe i rehabilitimit të kryesve të veprës është draftuar në fund të vitit 2022 dhe pritet të finalizohet në shtator të 2023 nga Ministria e Drejtësisë, si hartues i politikave sociale.<sup>61</sup>

57 Procedurat standarde të veprimit për mbrotjen kundër dhunës në familje ABGJ 2013

58 Shtojca 2. Tabela 3. Pjesëmarrja e ZMNV-se në procesin e trajtimit të viktimave

59 Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, ABGJ 2013

60 Intervistat në QPS-Prishtinë

61 Kurrikula për kryesit e veprës, MD

Në këto qendra nuk aplikohen metodat e psiko-terapisë e cila është vërtetuar të jetë ndihmuese për njerëzit që duan apo kanë nevojë të përmirësojnë sjelljet dhe aftësitë e tyre për përballje me problemet dhe vështirësitë e jetës.<sup>62</sup>

Mungesa e angazhimit të psikologëve në qendrat për punë sociale mund të ndikojë në mbështetje të kufizuar të shëndetit mendor. Po ashtu, mungesa e psikologëve mund të ndikojë në vlerësimet gjithëpërfshirëse dhe ndërhyrjet e duhura për viktimën.

Pa aktivitete të vetëdijesimit, kryesi i veprave mund të mos i kuptojë plotësisht pasojat e veprimeve apo të ndryshojnë sjelljen e tyre. Kjo mund të pengojë ri integrimin në shoqëri dhe rritjen e rasteve recidiviste.

- **Mos trajtimi i të gjitha rasteve nga Gjykatat**

*Gjykatat duhet ti shqyrtojnë me prioritet rastet e dhunës në familje. Këto raste trajtohen nga gjykata në procedurë civile apo penale varësisht nga natyra e rastit. Në procedurë civile, gjykatat shqyrtojnë kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente dhe shqyrtojnë masat mbrojtëse të parapara me ligj. Në procedurë penale, organet hetuese janë kompetente të vendosin për rastet e ndjekjes penale të kryerësve të dhunës në familje, të cilët kanë shkelur urdhrin për mbrojtje, ose personat që kanë kryer vepër penale në marrëdhënie familjare.<sup>63</sup>*

Pasqyrimin e gjendjes për trajtimin e rasteve nga ana e gjykatave është bërë vetëm nga të dhënat e ofruara statistikore.

Më poshtë janë shpalosur të dhënat statistikore për shqyrtimin e rasteve sipas procedurave penale dhe civile.

### **Rastet me procedurë penale**

Të dhënat statistikore na tregojnë se procesi i trajtimit në procedurë penale tek rastet e dhunës në familje merr kohë më shumë se një vit. Rreth 17-37% e lëndëve penale të shqyrtuara gjatë periudhës 2020-2022 janë raste të bartura nga vitet e mëhershme, disa prej tyre edhe nga viti 2016.

Të dhënat për numrin e lëndëve penale të shqyrtuara nga gjykatat gjatë periudhës 2020-2022, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

62 Shoqata shqiptare për psiko terapi <https://albpsychotherapy.wordpress.com/per-vizitoret/psikoterapia-e-grupit/>

63 Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhunë në familje ABGJ 2013, fq.23



**Tabela 6. Numri i lëndëve shqyrtuara nga Gjykatat**

| <b>Shqyrtimi i veprave Penale</b>    |                           |                                                              |                                       |                                                          |
|--------------------------------------|---------------------------|--------------------------------------------------------------|---------------------------------------|----------------------------------------------------------|
| <b>Gjykata Themelore - Prishtinë</b> |                           |                                                              |                                       |                                                          |
| Viti                                 | Total raste të shqyrtuara | Raste të shqyrtuara të cilat janë bartur nga vitet paraprake | Raste të shqyrtuara nga viti përkatës | Raste të shqyrtuara por të pazgjidhura nga viti përkatës |
| 2020                                 | 127                       | 41                                                           | 74                                    | 12                                                       |
| 2021                                 | 316                       | 53                                                           | 160                                   | 103                                                      |
| 2022                                 | 506                       | 172                                                          | 172                                   | 162                                                      |
| <b>Gjykata Themelore - Pejë</b>      |                           |                                                              |                                       |                                                          |
| 2020                                 | 42                        | N/A                                                          | 29                                    | 13                                                       |
| 2021                                 | 107                       | N/A                                                          | 31                                    | 76                                                       |
| 2022                                 | 293                       | 108                                                          | 79                                    | 106                                                      |

Burimi: Të dhënat statistikore të marra nga Gjykatat për periudhën 2020-2022

Nga tabela vërehet se në Gjykatat Themelore një numër i madh lëndëve nuk trajtohen brenda viteve përkatëse gjë që ngarkon sistemin e trajtimit të lëndëve me kohë. Kjo shkakton bartjen e lëndëve nga viti në vit, lëndë të pazgjidhura që mund të ndikojnë në humbje kohe në vendim marrje.

Lidhur me referimet e gjykatave për rehabilitim dhe trajtim psikiatrik si masa parandaluese të dhunës në familje, shihet se rastet e tilla janë në numër të vogël. Me konkretisht, 1-10 raste gjithsejtë brenda periudhës 2020-2022.

**Tabela 7. Numri i rasteve të referuara për rehabilitim dhe trajtim psikologjik, gjatë periudhës 2020-2022**

| <b>Gjykata Themelore - Prishtinë</b> |                                  |                                                                      |
|--------------------------------------|----------------------------------|----------------------------------------------------------------------|
|                                      | Trajtim i detyrueshëm psikiatrik | Trajtim rehabilitues për varësi nga alkooli dhe substancat narkotike |
| 2020                                 | 1                                | 2                                                                    |
| 2021                                 | 10                               | /                                                                    |
| 2022                                 | 6                                | 1                                                                    |
| <b>Gjykata Themelore - Pejë</b>      |                                  |                                                                      |
| 2020                                 | /                                | /                                                                    |
| 2021                                 | /                                | /                                                                    |
| 2022                                 | 2                                | /                                                                    |

Burimi: Të dhënat statistikore të marra nga Gjykatat për periudhën 2020-2022

## Rastet me procedurë civile

Sa i përket lëndëve civile të pranuar, si dhe nga kush janë parashtruar kërkesat për shqyrtimin e tyre vërejmë se në Gjykatat Themelore të Prishtinës dhe atë të Pejës, kërkesat për urdhër mbrojtje bëhen nga ana e mbrojtësve të viktimave, mirëpo ka raste kur kërkesat për urdhër mbrojtje bëhen drejtpërdrejtë edhe nga vet viktimat, si dhe në numër të vogël edhe nga ana e Prokurorisë dhe QPS-së. Këto raste të evidentuara mund të jenë si rezultat e mungesës së përfshirjes së mbrojtësit të viktimave në shqyrtim dhe inicim të kërkesave, mirëpo ka raste kur viktimat angazhon avokat privat për mbrojtje<sup>64</sup>. Më në detaje shihni tabelën në vijim.

**Tabela 8. Numri i kërkesave të shqyrtuara sipas Gjykatave, për periudhën 2020-2022**

| Shqyrtimi i lëndëve Civile   |                             |                          |                              |                                    |
|------------------------------|-----------------------------|--------------------------|------------------------------|------------------------------------|
| Gjykata Themelore -Prishtinë |                             |                          |                              |                                    |
| Viti                         | Total kërkesa të shqyrtuara | Kërkesa të bëra nga ZMNV | Kërkesa të bëra nga viktimat | Kërkesa të bëra nga Prokuroria/QPS |
| 2020                         | 145                         | 123                      | 20                           | 2                                  |
| 2021                         | 219                         | 191                      | 28                           | /                                  |
| 2022                         | 304                         | 274                      | 29                           | 1                                  |
| Gjykata Themelore - Pejë     |                             |                          |                              |                                    |
| 2020                         | 100                         | 89                       | 9                            | 2                                  |
| 2021                         | 52                          | 45                       | 6                            | 1                                  |
| 2022                         | 200                         | N/A                      | N/A                          | N/A                                |

Burimi: Të dhënat statistikore të marra nga Gjykatat për periudhën 2020-2022

Kemi vërejtur se përmbyllja e rasteve nga ana e Gjykatës mund të zgjasë me vite, edhe për shkaqe të ndryshme të rasteve të ndërlikuara apo recidiviste. Sipas dëshmive të ofruara është vërejtur se ka raste që kanë zgjatur më shumë se 5 vite, sepse dhuna në familje ka kaluar në dhunë ekonomike, probleme të divorcit dhe komplikime tjera. Në këto raste gjykata ka hapur procedurë në çdo padi të re të shkaktuar në ndërkohë dhe nuk ka qenë e mundur të mbyllet rasti.

Në përgjigjet e marra nga anketa tregojnë se 18 nga 40 të anketuarat nuk janë të kënaqura me trajtimin e tyre nga ana e Gjykatave. Këto pakënaqësi kanë të bëjnë me: 7 raste për vonesat në shqyrtim, në 3 raste kanë deklaruar se mungon paanshmëria dhe objektiviteti, në 2 raste kanë pas vërejtje lidhur me urdhrat mbrojtës; aprovimin apo vazhdimin e tyre sipas kërkesës, në 2 raste ka pasur vërejtje për çështje ekonomike si alimentacioni apo kompensimi financiar si dhe në 2 raste të tjera vërejtjet kanë pas të bëjnë me çështjet e kujdestarisë së fëmijëve.

64 Intervista me zyrtarët e ZMNV-së.

Vonesat në shqyrtimi e lëndëve të rasteve të dhunës në familje nga ana e Gjykatave mund të ndikojë që viktimat mos të arrijnë të marrin mbrojtjen e duhur nga ana e institucioneve të drejtësisë, si dhe kryesit e dhunës të mos marrin dënimin e merituar.

## 3.6. Baza e përbashkët e të dhënave

Në këtë kapitull, janë përfshirë gjetjet që kanë të bëjnë me: Data Bazën Nacionale (DBN) si sistem i përbashkët për regjistrimin e të dhënave themeluar nga Ministria e Drejtësisë, defektet në regjistrim dhe referim të rasteve nga institucionet publike, mos klasifikimi dhe priorizimi i rasteve sipas ndjeshmërisë së tyre.

- *Funksionimi i Data Bazës Nacionale për dhunën në familje*

*Data Baza Nacionale është një sistem i menaxhimit të rasteve që bënë të mundur të përcillen të mbijetuarat dhe rastet e tyre, të bëhen referime dhe të shihet se çfarë shërbimesh janë ofruar. Gjithashtu DBN lejon analizën e afateve kohore të hetimit, ndjekjes penale dhe vendimit, dhe regjistron masat e përkohshme (p.sh. urdhrat e mbrojtjes), vendimet e gjyqtarëve për akuzat dhe dënimet penale ose civile<sup>65</sup>.*

Zyra e Koordinatorit Nacional në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në mars të vitit 2019 ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit për themelimin e një data baze të përbashkët për mbledhjen e të dhënave nga të gjitha institucionet e përfshira në trajtimin e dhunës në familje.<sup>66</sup>

Duhet theksuar se Ministria e Drejtësisë nuk merret direkt me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, por mirëmban dhe zhvillon aplikacionin varësisht kërkesave të institucioneve.

DBN është një mjet në dispozicion të institucioneve përgjegjëse për të përmirësuar komunikimin e tyre me njëri-tjetrin, ku Policia, Drejtësia, Prokuroria, Qendrat për punë Sociale dhe Strehimoret janë në gjendje të fusin të dhënat për rastet e dhunës në familje.<sup>67</sup>

Kosova është i vetmi vend në regjion i cili mes 120 shteteve tjera ka arritur të krijoj një platformë virtuale që ka për qëllim të mundësoj analizën e afateve kohore të hetimit, si dhe të evidentoj masat e përkohshme siç janë urdhrat e mbrojtjes dhe vendimet e gjyqtarëve mbi akuzat dhe dënimet penale ose civile<sup>68</sup>. Pasqyra e regjistrimit të rasteve për dhunën në familje paraqet një sistem i cili ndihmon punën e akterëve përgjegjës që ti referojnë rastet tek njëri tjetri sipas nevojave të caktuara.<sup>69</sup>

65 UN Women. Kosovo to start using an integrated database for cases of domestic violence. April 2, 2019. <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2019/04/kosovo-to-start-using-an-integrated-database-for-cases-of-domestic-violence>

66 Memorandumi i mirëkuptimit, 2019, Funksionalizimi i bazës së integruar të të dhënave për rastet e dhunës në familje

67 Manuali i përdorimit; baza nacionale për rastet e dhunës në familje

68 Bazuar në sqarime e organizatës UN Women, National Data base for cases of GBV-DV Kosovo

69 Manuali i përdorimit: Baza Nacionale për Rastet e Dhunës në Familje

Më poshtë është paraqitur një pasqyrë e obligimeve të të gjithave institucioneve për regjistrimin e të dhënave e që në fakt paraqet një sistem të ndërruar në mes tyre.

**Tabela 9. Pasqyra e regjistrimit të rasteve në DBN të Dhunës në familje**

**POLICIA** - obligohet të regjistroj të dhënat sipas kategorisë dhe ti referoj ato në Prokurori, ZMNV, QPs dhe Strehimore

**ZMNV** - obligohet të regjistroj të rastet për iniciimin e procedurave gjyqësore - urdhër mbrojtjet, kompensimin e dëmit

**PROKURORIA** - obligohet të regjistroj të dhënat për përcaktimin e veprave penale

**GJYKATA** - obligohet të regjistroj numrin e rasteve të pranuar dhe të shqyrtuara; vendimin gjyqësorë; aktvendimet dhe masat tjera

**QPS** - obligohen të regjistrojnë rastet e trajtuara në aspektin socio - psikologjik, të divorceve dhe besimit të fëmijëve

**STREHIMORET** - obligohen të regjistrojnë rastet e pranuar nën kujdes përfshirë informata për fëmijët

Siç shihet nga pasqyra e paraqitur, tërë ky proces përbën një cikël të rëndësishëm të koordinimit dha bashkëpunimit të gjashtë akterëve me përgjegjësi, mandate dhe detyra të ndryshme, prandaj rastet nuk regjistrohen njësoj por përmes kodeve të veçanta. Për shembull, për tu regjistruar një rast në gjykatë, duhet të hapet numri specifik i atij rasti.<sup>70</sup>

Në bazë të observimit të regjistrimit në DBN, kemi vërejtur se kjo platformë përveç regjistrimit të rasteve, ofron edhe mundësinë e kategorizimit të tyre sipas veprave penale. Veprat penale të kategorizuara në data bazë, përfshijnë gjithsej 48 klasifikime, llojet e tyre janë paraqitur si shtojcë në fund të këtij raporti (Shtojca 2 tabela 5).

Është e rëndësishme të ceket se një nga rolet kryesore të kësaj DBN është eliminimi i dyfishimit të rasteve. Të gjitha veprimet e ndërmarra nga institucionet ndërlidhen me “Kartelën e rastit” gjë që mundëson secilit institucion të ndjek politikat e brendshme lidhur me shërbimet specifike që i ofron.<sup>71</sup> Sipas manualit nëse një person është i regjistruar në sistem atëherë sistemi nuk lejon të regjistrohet i njëjti përsëri<sup>72</sup>.

Edhe pse DBN ka pasur progres në disa institucione, nuk është arritur regjistrimi i plotë i rasteve nga të gjitha institucionet përgjegjëse.

Mënyrën e regjistrimit të rasteve nga institucionet e zotuar, është shpalosur më poshtë:

- *Dobësi në regjistrim dhe referim të rasteve nga institucionet publike*

*Institucionet përgjegjëse, duhet të bëjnë evidentimin/përditësimin e të dhënave në kohë reale* <sup>73</sup>.

Sipas observimeve dhe analizave të auditimit, funksionalizimi i DBN varet nga angazhimi i të gjitha institucioneve në regjistrimin e të dhënave. Vlen të ceket se institucionet përgjegjëse janë të obliguara të plotësojnë data bazën në mënyrë të pavarur për rastet e pranuar, prandaj data baza e MD ka module të ndara për secilin institucion dhe çdo institucion i regjistron të dhënat e veta, të cilat automatikisht ndërlidhen me butonin “Kartelë e rastit”.<sup>74</sup>

<sup>70</sup> Manuali i përdorimit fq 28

<sup>71</sup> Kartela e rastit është butoni i/ moduli I vecante I DB ku regjistrohen rastet me informata të caktuara nga secili institucion sipas shërbimeve që i kryejnë.

<sup>72</sup> Manuali i përdorimit: Baza Nacionale për Rastet e Dhunës në Familje, Pika, 2.1.2 Kërkimi i një viktime & 2.1.5 Referimi nga një akter te tjetri

<sup>73</sup> Manuali i përdorimit: Baza Nacionale për Rastet e Dhunës në Familje

<sup>74</sup> Kartela e rastit është buton I veqante ku përfshihen të gjitha të dhënat për çdo rast.

Në tabelën e më poshtme është dhënë një pasqyrë e rasteve të regjistruara nga institucionet përkatëse në nivel regjional.

**Tabela 10: Numri i rasteve të regjistruara në data bazë nga të gjitha institucionet përgjegjëse**

| INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE | REGJIONI I PRISHTINËS |      |      | REGJIONI I PEJËS |      |      |
|---------------------------|-----------------------|------|------|------------------|------|------|
|                           | 2020                  | 2021 | 2022 | 2020             | 2021 | 2022 |
| Periodha e auditimit:     |                       |      |      |                  |      |      |
| Policia                   | 764                   | 850  | 904  | 264              | 324  | 338  |
| Mbrojtësit e viktimave    | 46                    | 177  | 88   | 2                | 188  | 271  |
| Prokuroria                | 333                   | 411  | 430  | 1                | 0    | 0    |
| Gjykata                   | 0                     | 1    | 0    | 0                | 0    | 0    |
| Qendra për punë sociale   | 97                    | 109  | 211  | 14               | 36   | 13   |
| Strehimoret               | 45                    | 126  | 166  | 49               | 64   | 38   |

*Burimi, Informatat nga Ministria e Drejtësisë*

Njëri nga institucionet përgjegjëse që bën regjistrimin e të dhënave në DBN në mënyrë më të rregullt dhe të plotë është policia. Mangësi në regjistrimin e të dhënave ka sidomos në gjykata dhe prokurorinë e Pejës. Në këtë kontekst, duhet pasur parasysh se institucionet trajtojnë vetëm numrin e rasteve të cilat kalojnë në procedurat e tyre të parapara. Kjo mund të ndikojë që të kenë numër të ndryshëm të rasteve, pasi që jo të gjitha kalojnë nëpër institucionet që trajtojnë rastet e dhunës në familje. Mirëpo theksojmë se në të gjitha institucionet nuk janë bërë regjistrimet e plota të rasteve të pranuar.<sup>75</sup>

Në bazë të gjitha të dhënave përfundojmë se në DBN ekziston mungesë e regjistrimit të të dhënave të plota nga të gjitha institucionet përgjegjëse. Kjo do të thotë edhe pse secili nga institucionet duhet ti regjistroj të dhënat sipas fushëveprimit të tyre, kjo DBN nuk është plotësuar me të dhëna të plota nga asnjëri institucion përgjegjës.

Sipas informatave fillimisht kjo ka ndodhur për shkaqe teknike të cilat nuk janë korrigjuar, kurse gjithashtu ka munguar vullneti i institucioneve për të raportuar dhe përmbushur obligimin sipas marrëveshjes së nënshkruar<sup>76</sup>. Ngecjet e data bazës reflektojnë në referim dhe planifikim të dobët të rasteve si dhe në pasaktësinë e të dhënave statistikore.

<sup>75</sup> Intervistat me autoritetet e QPS dhe Strehimoret

<sup>76</sup> Intervistat e autoriteteve të ZMNV, Prishtinë Pejë, Prokuroria Pejë, QPS,

- *Mos klasifikimi dhe prioritizimi i rasteve në DBN sipas ndjeshmërisë së tyre*

*Sipas udhëzuesit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje kategorizimi i rasteve duhet të bëhet për trajtim më efikas të veprave dhe unifikim të praktikës ligjore.<sup>77</sup>*

Pikënisja e trajtimit dhe referimit të institucioneve tjera për regjistrimin e rasteve fillon në stacionet policore andaj analizat tona janë fokusuar në këtë entitet. Edhe pse kategorizimi i rasteve është paraparë si një domosdoshmëri për trajtim me prioritet të rasteve të ndjeshme, një metodë e tillë e punës nuk është aplikuar në regjistrimet e bëra nga stacionet policore. Rastet e paklasifikuara në SP Prishtinë janë në nivel shumë më të lartë se sa i atyre të klasifikuara, kurse në SP Pejë kategorizimi i rasteve ka qenë në nivel pak më të mirë.

Kemi vërejtur se në stacionet policore, në Prishtinë dhe Pejë, regjistrimi i rasteve dhe kategorizimi i tyre bëhet sipas një udhëzuesi të lëshuar nga Gjykata supreme<sup>78</sup>. Parimet kryesore të këtij udhëzuesi janë të ndara në shtatë fusha kryesore. Mirëpo, kemi vërejtur se si në SP Prishtinë ashtu edhe në SP Pejë ka pasur vazhdimisht dyfishime të kategorive të rasteve të natyrës së njëjte sepse regjistrimi i tyre është bërë nga secili hetues me emërtime të ndryshme.

Një tendencë për të unifikuar regjistrimet e ka pasur edhe DBN për dhunën në familje ku janë vënë në dispozicion 48 kategori të ndryshme të cilat janë bazuar në Kodin Penal dhe Ligjin mbi dhunën në familje.<sup>79</sup> Mirëpo, vlen të ceket se kategoritë e DBN nuk janë në përshtatje me kategoritë e përcaktuara me udhëzuesin e Gjykatës Supreme.<sup>80</sup>

Në mungesë të kategorizimit unik të rasteve, një numër i madh i tyre kanë mbetur të pa klasifikuara, janë regjistruar vetëm si raste të dhunës në familje.

Një pasqyrë të rasteve të klasifikuara në raport me ato të pa klasifikuara ne Stacionet Policore i kemi paraqitur në grafikun e më poshtëm:


<sup>77</sup> Udhëzim, cilësimi juridik dhe trajtim, i rasteve të dhunës në familje KPRK, Gjykata Supreme

<sup>78</sup> Udhëzim lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit penal të RK-së. Qershor 2020

<sup>79</sup> Kategoritë e data bazës nacionale për dhunën në familje, Ministria e drejtësisë

<sup>80</sup> Shih tabelën e kategorizimit në DBN

**Grafiku 8: Diferenca ndër vite mes rasteve të kategorizuar dhe të pa kategorizuara sipas regjistrave në stacionet policore: Prishtinë dhe Pejë**



*Burimi i informatave, te dhënat nga stacionet policore, Prishtinë dhe Pejë*

Siç shihet nga grafiku në SP Prishtinë shumica e rasteve ndër vitet 2020-2022 ka mbetur e grupuar vetëm si dhunë në familje, niveli i rasteve të klasifikuara është shumë i ulët. Përderisa në SP Pejë janë bërë përpjekje që rastet të klasifikohen në një nivel më të mirë.




Për një pasqyrë më të qartë, më poshtë kemi paraqitur se si duket përqindja e rasteve të prioritizuara në bazë të llojit të lëndimit si: lëndim i rëndë, lëndim i lehtë, sulm, apo kategori të tjera. Vërehet se mbi 90% të rasteve nuk klasifikohen fare në SP Prishtinë, kurse në SP Pejë nuk klasifikohen mbi 60% të rasteve.

Prioritizimi i rasteve në bazë të kategorive- SP Prishtinë dhe Pejë gjatë viteve 2020-2022


**Grafiku 9: SP Prishtinë**

**Stacioni Policorë Prishtinë**



**Grafiku 10: SP Pejë**

**Stacioni Policorë Pejë**



SP Prishtinë, gjatë tri viteve ka klasifikuar vetëm 3-4% të rasteve, në kategoritë si: mos respektim i urdhrit të gjykatës/sulm/lëndim i lehtë trupor/të tjera. Kurse 94-95% të rasteve janë regjistruara si të kategorisë së përgjithshme. SP i Pejës, gjatë tre viteve ka klasifikuar 2-23% të rasteve në kategoritë: lëndim i rëndë trupor/lëndim i lehtë truporë/sulm/kategori të tjera. Kurse 57-68% janë klasifikuar si kategori e përgjithshme.

Kjo ka ndodh ngase njësitet për dhunë në familje në SP shfrytëzojnë të njëjtin udhëzim për regjistrimin dhe ndarjen e rasteve të dhunës në familje, si dhe të njëjtin manual të DBN-së, por ka shumë paqartësi se si ato të regjistrohen në mënyrë unike. Numri i kategorive të ofruara në DBN për dhunën në familje ka ndikim gjatë procesit të regjistrimit, duke sjellë mundësinë e komplikimeve dhe pasigurisë në lidhje me mënyrën e saktë të regjistrimit<sup>81</sup>.

Klasifikimi i dobët dhe jo unik i rasteve ka reflektuar në mos prioritizimin e tyre, gjë që ndikon në mobilizim dhe planifikim të mangët të aktiviteteve për të mundësuar ndërmarrjen e masave adekuate për rastet e caktuara të dhunës në familje.

---

81 Kategoritë e data bazës, Ministria e drejtësisë

# KONKLUSIONEN

04

## 4. Konkluzionet

Institucionet përgjegjëse publike kanë ndërmarrë një sërë veprimesh për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, si në aspektin e hartimit të kornizës ligjore po ashtu edhe në aspektin e reagimit, mbrojtjes dhe rehabilitimit. Mirëpo për të realizuar efektivitetin e këtyre shërbimeve kërkohet një angazhim institucional shumë më i madh. Në aspektin e reagimit emergjent sistemi shtetëror funksionon relativisht mire. Në aspektin e mbrojtjes sistemi shtetëror ka defekte gjatë marrjes së deklaratave nga palët e përfshira në incident, në regjistrimin e rasteve të raportuara, përfshirje të mbrojtësve të viktimave si dhe shqyrtim të rasteve me kohë nga organet e drejtësisë. Ndërsa në aspektin e rehabilitimit, viktimat nuk kanë përkrahje sociale, si dhe mungojnë programet për trajtim të kryesve të veprës. Megjithatë, që këto shërbime të jenë vërtet efektive dhe me ndikim, nevojitet një nivel dukshëm më i lartë i angazhimit institucional.

Për sa i përket reagimit ndaj emergjencave, institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë veprime për të trajtuar rastet e dhunës në familje dhe sistemi i tyre i reagimit emergjent funksionon relativisht mirë. Krijimi i linjës telefonike të urgjencës 24/7 ka lehtësuar qasjen në kohë në polici, duke siguruar ndërhyrje të menjëhershme në rastet e raportuara të dhunës në familje. Përgjigja e menjëhershme nga zyrtarët e policisë mundëson ofrimin e shërbimeve thelbësore të urgjencës, duke përfshirë ndihmën e parë dhe strehimin e përkohshëm, duke siguruar gjithashtu prova jetike nga vendi i krimit. Megjithatë, kufizimet lindin për shkak të ngarkesës së hetuesve primar që pamundëson fokusimin vetëm në rastet e dhunës në familje. Duke pasur parasysh përgjegjësitë e tyre të njëkohshme me hetimet e tjera, kjo mund të rezultojë në një trajtim jo adekuat të rasteve të dhunës në familje.

Sa i përket mbrojtjes, në sistemin shtetëror janë evidentuar disa mangësi në drejtim të mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje. Monitorimit të zbatimit të urdhrave mbrojtës i mungon një procedurë e standardizuar, duke çuar në mbikëqyrje të paqëndrueshme dhe boshllëqe të mundshme në mbështetjen e viktimave në aspektin e sigurisë fizike. Vlerësimi fillestar i rrezikut i kryer nga hetuesit e policisë, megjithëse një hap pozitiv, kërkon udhëzime dhe procedura më të qarta për konsistencë dhe drejtësi. Për më tepër, mospërputhjet në regjistrimin e të dhënave në nivele të ndryshme institucionale nënvizojnë nevojën për mbikëqyrje rigoroze për të siguruar saktësinë dhe integritetin e të dhënave. Mungesa e shkëmbimit të informatave të sakta dhe të plota ndërmjet policisë dhe mbrojtësve të viktimave pengojnë mbështetjen në kohë dhe gjithëpërfshirëse të viktimave.

Në aspektin e rehabilitimit mund të përfundojmë se viktimat nuk marrin mbështetjen e duhur. Strehimoret, pavarësisht se ofrojnë shërbime rehabilitimi emergjent, hasin në pengesa në funksionimin e tyre për shkak të bashkëpunimit dhe mbështetjes së pamjaftueshme institucionale. Procesi pengohet nga vonesat në seancat gjyqësore dhe mungesa e informacionit për procesin gjyqësor. Mungon mbështetja psikologjike për viktimat dhe mungojnë programet për rehabilitimin e autorëve. Gjithashtu, viktimat nuk janë gjithmonë të informuara për të drejtën e tyre për kompensim material gjatë kësaj faze.

Ndërkohë që institucionet publike përgjegjëse kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të adresuar dhunën në familje, mbeten mangësi thelbësore që kërkojnë vëmendje dhe veprim urgjent. Rritja e angazhimit institucional për të trajtuar dhunën në familje dhe shpërndarja adekuate e burimeve janë hapa kyç. Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara dhe rritja e trajnimit profesional do të forcojnë reagimin e përgjithshëm ndaj dhunës në familje. Për më tepër, zhvillimi i programeve gjithëpërfshirëse të rehabilitimit për viktimat, duke përfshirë mbështetjen psikologjike dhe kompensimet materiale, është jetik. Njëkohësisht, adresimi i rehabilitimit të autorëve përmes programeve të synuara është thelbësor për trajtimin dhe rikuperimin e tyre.

Mangësitë në sistemin e menaxhimit të të dhënave, veçanërisht mungesa e angazhimit mbarë institucional për regjistrimin e të dhënave në Data Bazën Nacionale për rastet e dhunës në familje, pengojnë monitorimin dhe analizën efektive të rasteve të dhunës në familje. Regjistrimi i paqëndrueshëm i të dhënave ndërlikon më tej përpjekjet për të kapur informacion të saktë, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje të unifikuar për futjen e të dhënave.

Nëpërmjet përpjekjeve të vazhdueshme dhe angazhimit për ndryshim, institucionet përgjegjëse mund të nxisin një mjedis ku viktimat e dhunës në familje mbrohen, rehabilitohen dhe fuqizohen, duke kontribuar përfundimisht në çrrënjosjen e dhunës në familje nga shoqëria.

# REKOMANDIMET

05

## 5. Rekomandimet

Rekomandimet e mëposhtme kanë për qëllim që të përmirësojnë procesin e trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Ato janë adresuar për secilin nga institucionet përgjegjëse, sipas defekteve të identifikuara gjatë auditimit.

### **Rekomandojmë Policinë e Kosovës:**

- *Përmirësimi i saktësisë dhe konsistencës së të dhënave në regjistrimin e rasteve të dhunës në familje në nivelet institucionale.*
- *Të rritet komunikimi dhe koordinimi ndërmjet policisë, mbrojtësve të viktimave dhe strehimoreve për të siguruar mbështetje në kohë dhe efektive për viktimat.*
- *Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të përcaktojnë kategoritë unike të data bazës për kategorizimin e rasteve gjatë regjistrimit.*

### **Rekomandojmë Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave**

- *Të përcaktoj një afat sa më shkurtër kohor dhe ti përmbahet këtij afati brenda të cilit të kontaktohet patjetër viktimat e identifikuar.*
- *Të angazhohen që viktimave t'ju ofrohen informatave të plota rreth procesit gjyqësor, duke përfshirë urdhrat mbrojtës, kompensimet materiale dhe të drejtat e tyre gjatë rehabilitimit.*
- *Të bëjnë regjistrimin e të dhënave në data bazë për të gjitha rasteve që trajtohen nga ana e tyre.*

## Rekomandojmë Qendrat për Punë Sociale:

- Të angazhohen që të përcaktojnë punëtorët social të cilët duhet të kenë prioritet trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Kjo do të ndihmojë profilizimin e tyre dhe trajtimin më kompetent të këtyre rasteve sociale. Angazhimi i menaxherëve të rastit të bëhet me kohë dhe të njëjtit të përcjellin çdo rast nga fillimi deri në mbyllje.
- Të angazhohen në zhvillimin e programeve dhe aktiviteteve psikologjike të nevojshme për trajtimin e viktimave, kryesve të veprës apo pjesëmarrësve të tjerët të përfshirë në mënyrë direkte apo indirekte në incident.
- Në bashkëpunim me institucionet tjera të nivelit qendror dhe lokal të angazhohen në zhvillimin e programeve gjithëpërfshirëse të rehabilitimit, për të siguruar integrimin social dhe ekonomik të viktimave të dhunës në familje.
- Të regjistrojnë të dhënat në data bazën nacionale për shërbimet e ofruara për rastet e kësaj kategorie.

## Rekomandojmë Prokuroritë Themelore:

- Të bëjë përpjekje që të shqyrtojë mundësitë për trajtimin e të gjitha rasteve të dhunës në familje sipas prioriteteve të përcaktuara.
- Të bëjnë regjistrimin e të dhënave në data bazën nacionale, të të gjitha rasteve të trajtuara nga ana e tyre përfshirë të dhënat për përcaktimin e veprave penale.

## Rekomandojmë Gjykatat Themelore:

- Ti shqyrtojnë lëndët, duke filluar nga ato që janë transferuar nga vitet e mëparshme, kurse shqyrtimi i lëndëve nga vitet aktuale të prioritizohen sipas nivelit të rrezikut.
- Të bëjnë regjistrimin e të dhënave në data bazë, për numrin e rasteve të pranuar dhe të shqyrtuara nga ana e tyre; vendimet gjyqësorë, aktvendimet dhe masat tjera.



## Rekomandojmë Ministrinë e Drejtësisë:

- Të siguroj se regjistrohen rastet në bazën e të dhënave në mënyrë që të gjurmohen me saktësi rastet e dhunës në familje, referimet dhe procedurat e trajtimit.
- Të angazhohet për unifikimin e regjistrimeve në data bazë, në veçanti regjistrimet e bëra nga policia të cilat duhet të jenë në përshtatje me udhëzuesin e gjykatës supreme.
- Të angazhohet në zbatimin e programit të hartuar për trajtimin e kryesve të veprës në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse.
- Të rishikoj dhe përditësoj rregullisht politikat dhe udhëzimet ekzistuese në lidhje me dhunën në familje për të adresuar sfidat në zhvillim dhe për të përfshirë praktikatat më të mira.
- Të ofrojë mbështetje institucionale për fuqizimin e strehimoreve dhe qendrave për punë sociale në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e programeve gjithëpërfshirëse të rehabilitimit.

SHTOJCAT

06

## 6. Shtojca 1. Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

### Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi është Ministria e Drejtësisë, përkatësisht Zyra e Koordinatorit Nacional për Mbrojtje nga dhuna në familje me fokus të veçantë data baza e të dhënave e instaluar në këtë zyre.

Në mënyrë që të gjeturat e auditimit për procesin e trajtimit të rasteve të raportuara të dhunës në familje të jenë sa më përfaqësuese, kemi përzgjedhur dy regjione: Regjionin e Prishtinës dhe Regjionin e Pejës për shkak se këto dy regjione kanë numrin më të madh të rasteve të raportuara të dhunës.

Në kuadër të këtyre regjioneve si subjekte kryesore të këtij auditimi, kemi përzgjedhur institucionet përgjegjëse gjatë procesit të trajtimit të rasteve si:

- *Për Regjionin e Prishtinës: Policinë në nivel lokal, Mbrojtësit e Viktimave, Prokurorinë Themelore, Gjykatën Themelore, Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë. Pasi që strehimoret funksionojnë si Organizata jo qeveritare, në strehimoren e Prishtinës kemi bërë vetëm vëzhgim.*
- *Për Regjionin e Pejës: Policinë në nivel lokal, Mbrojtësit e Viktimave, Prokurorinë Themelore, Gjykatën Themelore, Qendrën për Punë Sociale në Pejë. Në strehimoren e Pejës kemi bërë vetëm vëzhgim.*

## Metodologjia e auditimit

Në këtë auditim janë përdorur një varg teknikash për të siguruar dëshmi relevante, të besueshme dhe të mjaftueshme, të cilat na shpijnë në identifikimin e mangësive të proceseve respektivisht aktiviteteve.

Metodologjia e përdorur në këtë auditim është si në vijim:

- *Analizimi i kornizës ligjore dhe rregullative lidhur me procesin e trajtimit të rasteve të dhunës në familje;*
- *Analizimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020 dhe 2022-2026;*
- *Analizimi i Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në familje;*
- *Analizimi i raporteve dhe hulumtimeve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që ndërlidhen me trajtimin e rasteve të dhunës në familje;*
  - *Zhvillimi i intervistave me zyrtarët e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje;*
- *Analizimi i procesverbaleve nga takimet e mbajtura nga Grupi Koordinues Ndër-ministror kundër dhunës në familje;*
- *Analizimi i të dhënave/statistikave nga baza e integruar e të dhënave në Zyrën e Koordinatorit Nacional për mbrojtje nga dhuna në familje;*
- *Analizimi i raporteve vjetore si dhe të dhënave statistikore për periudhën 2020-2022;*
- *Zhvillimi i anketës me të gjitha strehimoret në nivel vendi;*
- *Vëzhgimi fizik në terren i strehimoreve;*
- *Aplikimi i pyetësorëve për hulumtime, tek përfituesit e shërbimeve në strehimore; gjithsej intervistimi i 40 banoreve të strehuara gjatë periudhës 2020-2022*
- *Dokumentacion tjetër relevant për punën tonë audituese.*

## Shtojca 2.

Tabela 11. Koha e reagimit të policisë në rastet e dhunës në familje

| Kohëzgjatja e reagimit dhe intervenimit policorë në rastet e dhunës në familje |                                       |                                     |                                        |
|--------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|-------------------------------------|----------------------------------------|
| Numri i rastit                                                                 | Vendndodhja e incidentit të raportuar | Kategoria e veprës                  | Kohëzgjatja e procedurave të trajtimit |
| STACIONI POLICORË I PRISHTINËS                                                 |                                       |                                     |                                        |
| R 1                                                                            | Prishtinë                             | Mospërfillja e urdhërit të gjykatës | 0h 50"                                 |
| R 2                                                                            | Prishtinë                             | Lëndim i lehtë                      | 0h 30"                                 |
| R 3                                                                            | Prishtinë                             | Klasifikim i përgjithshëm           | 2h                                     |
| R 4                                                                            | Prishtinë                             | Klasifikim i përgjithshëm           | 1h                                     |
| R 5                                                                            | Prishtinë                             | Lëndim i lehtë                      | 4h 50"                                 |
| R 6                                                                            | Prishtinë                             | Klasifikim i përgjithshëm           | 2h 15"                                 |
| R 7                                                                            | Prishtinë                             | Klasifikim i përgjithshëm           | 0h 30"                                 |
| R 8                                                                            | Prishtinë                             | Klasifikim i përgjithshëm           | 3h 15"                                 |
| R 9                                                                            | Mitrovicë-Prishtinë                   | Mospërfillje e urdhërit të gjykatës | 4h                                     |
| R 10                                                                           | Prishtinë                             | Mospërfillje e urdherit te gjykate  | 4h                                     |
| R 11                                                                           | Prishtinë                             | Klasifikim i pergjithshem           | 2h 40"                                 |
| R 12                                                                           | Prishtinë                             | Klasifikim i përgjithshëm           | 5h 50"                                 |
| STACIONI POLICORË I PEJËS                                                      |                                       |                                     |                                        |
| R 10                                                                           | Prishtinë                             | Klasifikim i përgjithshëm           | 2h 40"                                 |
| R 11                                                                           | Prishtinë                             | Klasifikim i përgjithshëm           | 5h 50"                                 |
| R 12                                                                           | Prishtinë                             | Kanosje                             | 2h 45"                                 |
| R 13                                                                           | Leshan                                | Klasifikim i përgjithshëm           | 3 h                                    |
| R 14                                                                           | Vitimirice                            | Sulm                                | 3 h 30 "                               |
| R 15                                                                           | Gorazhdec                             | Lëndim i rënd                       | 5 h 45"                                |
| R 16                                                                           | Trebovic- Vitimirice                  | Lëndim i lehtë                      | 3 h 45 "                               |
| R 17                                                                           | Pejë                                  | Lëndim i rënd                       | 1 h 15"                                |
| R 18                                                                           | Pejë                                  | Klasifikim i përgjithshëm           | 3 h 25 "                               |
| R 19                                                                           | Buqan                                 | Lendim i rënd                       | 1h 35 "                                |
| R 20                                                                           | Peje                                  | Klasifikim i përgjithshëm           | 2 h 15 "                               |
| R 21                                                                           | Pejë                                  | Klasifikim i përgjithshëm           | 13 h                                   |
| R 22                                                                           | Klinë                                 | Klasifikim i përgjithshëm           | 3 h                                    |
| R 23                                                                           | Kosuric                               | Lëndim i rëndë                      | 4 h                                    |
| R 24                                                                           | Pejë                                  | Sulm                                | 3 h 45 "                               |

**Tabela 12. Numri i hetuesve në stacionet policore në nivel lokal dhe në njësinë rajonale të hetimeve në Prishtinë dhe Pejë, si dhe angazhimi i tyre në trajtimin e rasteve të dhunës në familje si dhe veprave tjera penale.**

| ST.Policor NJHP - Prishtinë |  | 2020             |                    | 2021             |                    | 2022             |                    |
|-----------------------------|--|------------------|--------------------|------------------|--------------------|------------------|--------------------|
| NJHP                        |  | Dhunë në familje | Vepra penale tjera | Dhunë në familje | Vepra penale tjera | Dhunë në familje | Vepra penale tjera |
| Hetuesi 1                   |  |                  |                    | 2                | 13                 | 2                | 9                  |
| Hetuesi 2                   |  | 3                | 21                 | 4                | 22                 | 5                | 16                 |
| Hetuesi 3                   |  |                  |                    | 4                | 8                  | 3                | 20                 |
| Hetuesi 4                   |  | 3                | 7                  |                  |                    |                  |                    |
| ST.Policor QENDRA           |  |                  |                    |                  |                    |                  |                    |
| Hetuesi 1                   |  | 65               | 4                  | 81               | 8                  | 38               | 17                 |
| Hetuesi 2                   |  | 24               | 96                 | 55               | 53                 | 57               | 92                 |
| Hetuesi 3                   |  |                  |                    |                  |                    | 0                | 0                  |
| Hetuesi 4                   |  |                  |                    |                  |                    | 22               | 50                 |
| ST.Policor JUGU             |  |                  |                    |                  |                    |                  |                    |
| Hetuesi 1                   |  | 61               | 55                 | 51               | 37                 | 62               | 16                 |
| Hetuesi 2                   |  | 56               | 99                 | 58               | 49                 | 66               | 46                 |
| Hetuesi 3                   |  | 2                | 110                | 24               | 34                 | 34               | 46                 |
| Hetuesi 4                   |  |                  |                    |                  |                    | 1                | 42                 |
| ST.Policor VERIU            |  |                  |                    |                  |                    |                  |                    |
| Hetuesi 1                   |  | 75               | 96                 | 72               | 93                 | 68               | 62                 |
| Hetuesi 2                   |  | 29               | 58                 |                  | 127                | 45               | 37                 |
| Hetuesi 3                   |  |                  |                    | 23               | 120                | 43               | 103                |
| Hetuesi 4                   |  |                  |                    |                  |                    | 0                | 35                 |
| ST.Policor NJHP -Pejë       |  | 2020             |                    | 2021             |                    | 2022             |                    |
| NJHP                        |  | Dhunë në familje | Vepra tjera penale | Dhunë në familje | Vepra tjera penale | Dhunë në familje | Vepra tjera penale |
| Hetuesi 1 & 2               |  | 0                | 9                  | 3                | 13                 | 14               | 19                 |
| ST.Policor                  |  |                  |                    |                  |                    |                  |                    |
| Hetuesi 1                   |  | 2                | 93                 | 15               | 72                 | 103              | 21                 |
| Hetuesi 2                   |  | 9                | 9                  | 66               | 52                 | 56               | 77                 |
| Hetuesi 3                   |  | 4                | 87                 | 26               | 119                | 35               | 127                |

Tabela 13. Pjesëmarrja e ZMNV-se në procesin e trajtimit të viktimave

| Nr i rastit                               | Data e raportimit të rastit ne polici | Koha/periudha e përfshirjes së Mbrojtësit të Viktimave   | Përfshirja në tërë procesin e trajtimit të rasteve |
|-------------------------------------------|---------------------------------------|----------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| ZYRA PËR MBROJTËSIT E VIKTIMAVE PRISHTINË |                                       |                                                          |                                                    |
| R 1                                       | 5/12/2020                             | Pjesëmarrje në proces deri me datën 14.02.2020           | Nuk ka vazhdimësi në përfshirje                    |
| R 2                                       | 1/12/2021                             | Nuk ka evidenca për pjesmarrjen e mbrojtësit të viktimës | Nuk ka informata                                   |
| R 3                                       | 7/6/2020                              | Nuk ka evidenca për pjesmarrjen e mbrojtësit të viktimës | Nuk ka informata                                   |
| R 4                                       | 8/25/2020                             | Nuk ka evidenca për pjesmarrjen e mbrojtësit të viktimës | Nuk ka informata                                   |
| R 5                                       | 8/20/2021                             | Pjesmarrje në proces deri me datën 09 06 2021            | Nuk ka vazhdimësi në përfshirje                    |
| R 6                                       | 11/10/2021                            | Pjesmarrje në proces deri me datën 31.08.2021            | Nuk ka vazhdimësi në përfshirje                    |
| R 7                                       | 3/18/2021                             | Pjesmarrje në proces deri me datën 24.12.2020            | Nuk ka vazhdimësi në përfshirje                    |
| R 8                                       | 10/23/2021                            | Nuk ka evidenca për pjesmarrjen e mbrojtësit të viktimës | Nuk ka informata                                   |
| R 9                                       | 7/3/2022                              | Pjesmarrje në proces nga data 21.11.2022                 | Përfshirje e ZMNV brenda 90 ditësh                 |
| R 10                                      | 5/17/2022                             | Pjesmarrje në proces nga data 18.05.2022                 | Përfshirje e ZMNV brenda 2 ditësh                  |
| R 11                                      | 11/29/2022                            | Pjesmarrje në proces nga data 05.12.2022                 | Përfshirje e ZMNV brenda 5 ditësh                  |
| R 12                                      | 9/4/2022                              | Nuk ka evidenca për pjesmarrjen e mbrojtësit të viktimës | Nuk ka informata                                   |

| ZYRA PËR MBROJTËSIT E VIKTIMAVE PEJË |            |                                                          |                                    |
|--------------------------------------|------------|----------------------------------------------------------|------------------------------------|
| R 13                                 | 2/9/2020   | Pjesëmarrje në proces nga data 24.02.2020                | Përfshirje e ZMNV brenda dy ditësh |
| R 14                                 | 3/17/2020  | Pjesëmarrje në proces nga data 03.06.2020                | Përfshirje e ZMNV brenda 60 ditësh |
| R 15                                 | 6/12/2020  | Nuk kanë arritur të kontaktojnë viktimen                 | Nuk ka përfshirje                  |
| R 16                                 | 8/25/2020  | Nuk kanë arritur të kontaktojnë viktimën                 | Nuk ka vazhdimësi në përfshirje    |
| R 17                                 | 1/13/2021  | Pjesëmarrje në proces nga data 15.02.2021                | Përfshirje e ZMNV brenda 30 ditësh |
| R 18                                 | 4/2/2021   | Pjesëmarrje në proces nga data 12.06.2021                | Përfshirje e ZMNV brenda 60 ditësh |
| R 19                                 | 4/24/2021  | Pjesëmarrje në proces nga data 30.04.2021                | Përfshirje e ZMNV brenda 15 ditësh |
| R 20                                 | 7/26/2021  | Pjesëmarrje në proces nga data 03.08.2021                | Përfshirje e ZMNV brenda 15 ditësh |
| R 21                                 | 4/19/2022  | Pjesëmarrje në proces nga data 05.05.2022                | Përfshirje e ZMNV brenda 15 ditësh |
| R 22                                 | 6/27/2022  | Pjesëmarrje në proces nga data 11.11.2022                | Përfshirje e ZMNV brenda 90 ditësh |
| R 23                                 | 10/12/2022 | Nuk ka evidenca për pjesëmarrjen e mbrotësit të viktimës | Nuk ka vazhdimësi në përfshirje    |
| R 24                                 | 11/16/2022 | Pjesëmarrje në procese nga data 07.12.2022               | Përfshirje e ZMNV brenda 15 ditësh |



Tabela 14. Shërbimet e ndërmarra nga Qendrat për Punë Sociale

| SHERBIMET SOCIALE TE NDERMARRA NE QPS PRISHTINË                      |                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                 |
|----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Statusi social dhe vendqëndrimi gjatë kohës së dhunës                | Kohëzgjatja e trajtimit                                                                                                                                                 | Intervenimet e përgjithshme nga menaxheri i rastit                                                                                                                                              |
| Nuk ka kaluar neper strehimore                                       | Është trajtuar nga QPS gjate vitit 2019. Për këtë rast nuk ka pasur aktivitete ne vitin 2020/22 edhe pse rasti ka vazhduar te trajtohet nga organet tjera te drejtësisë | Karakteristik e këtij rasti është se gjatë vitit 2019 janë përpiluar tri anamneza sociale për gjykatën themelore në karakterin e propozimeve                                                    |
| Nuk ka kaluar neper strehimore                                       | Gjatë dy muajve në vitin 2021                                                                                                                                           | Sesion këshillues individual me klientin, Sesion këshillues familjar, Konsultim për rastin, Ndihmë e përgjithshme për klientin, Konsultime te vazhdueshme për shkak te kujdestarisë se fëmijëve |
| Nuk ka kaluar neper strehimore                                       | Gjatë viteve 2020-22                                                                                                                                                    | Konsultime, ndërmjetësim i takimeve me fëmijët, kontakte te vazhdueshme me viktimën, përpilimi i planeve të shërbimeve për aktivitetet e realizuara lidhur me rastin                            |
| Nuk ka kaluar nëpër strehimore                                       | Gjatë një muaji                                                                                                                                                         | Konsultim për rastin<br>Vizita rreth gjendjes së klientit                                                                                                                                       |
| Nuk ka kaluar nëpër strehimore                                       | Gjatë një muaji                                                                                                                                                         | Sesion këshillues individual me klientin<br>Sesion këshillues familjar<br>Konsultim për rastin<br>Ndihmë e përgjithshme për klientin                                                            |
| Nuk ka kaluar nëpër strehimore                                       | Gjatë periudhës prej shtatë muajve                                                                                                                                      | Sesion këshillues individual me klientin<br>Konsultim për rastin<br>Vizita rreth gjendjes se klientit<br>Kategori e pa specifikuar                                                              |
| SHERBIMET SOCIALE TE NDERMARRA NE QPS PEJË                           |                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                 |
| Statusi social dhe vendqëndrimi gjatë kohës së dhunës                | Kohëzgjatja e trajtimit                                                                                                                                                 | Intervenimet e përgjithshme nga menaxheri i rastit                                                                                                                                              |
| Është strehuar në strehimore                                         | Gjatë një muaji                                                                                                                                                         | Sesion këshillues individual me klientin<br>Sesion këshillues familjar<br>Konsultim për rastin                                                                                                  |
| Disa herë radhazi në kohë të shkurtër të qëndrimit (Rast recidivist) | Ne vazhdimësi dhe sipas nevojës së paraqitur                                                                                                                            | Sesion këshillues individual me klientin<br>Sesion këshillues familjar<br>Konsultim për rastin<br>Ndihmë e përgjithshme për klientin                                                            |

**Tabela 15. Llojet e veprave penale në DBN**

|                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Sklavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar                    |
| Vrasja e rëndë                                                                      |
| Shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje                                      |
| Ndërprerja e palejuar e shtatzënësisë                                               |
| Vrasja e foshnjës gjatë lindjes                                                     |
| Vrasje në tentativë                                                                 |
| Kanosja                                                                             |
| Ngacmimi                                                                            |
| Sulmi                                                                               |
| Lëndimi i lehtë trupor                                                              |
| Lëndimi i rëndë trupor                                                              |
| Shtrëngimi                                                                          |
| Privimi i kundërligjshëm i lirisë                                                   |
| Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve                                   |
| Dhunimi                                                                             |
| Sulmi seksual                                                                       |
| Degradimi i integritetit seksual                                                    |
| Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale |
| Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare                              |
| Keqpërdorim i fëmijëve në pornografi                                                |
| Mundësim ose detyrim në prostitucion                                                |
| Mardhëniet seksuale brenda familjes                                                 |
| Martesa e detyruar                                                                  |
| Bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën 16 vjet                            |
| Marrja ose mbajtja e kundërligjshme e fëmijës                                       |
| Ndryshimi i statusit familjar të fëmijës                                            |
| Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës                                                 |
| Shkelja e detyrimeve Familjare                                                      |
| Braktisja e personave të paaftë                                                     |
| Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës                                          |

Uzurpimi i paligjshëm i pronës

Shantazhi

Dhuna në familje - Neni 248

Vetëgjyqësia

Çdo veprim tjetër i një anëtarit të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike

Shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit

Sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat

Ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë

Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përruljes së personit tjetër

Marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual

Kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër

Dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë

Vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike

Hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër

Rrëmbim i personit

Shkelja e udhërit mbrojtës

Mospërfillja e Gjykatës - Neni 401


Veprat penale të narkotikëve

Burimi: Informata nga data baza e Ministrisë së Drejtësisë<sup>82</sup>

82 Llojet e veprave penale në Data Bazën e të dhënave

**Grafiku 10. Rezultatet e anketës për nivelin e kënaqshmërisë me shërbimet e ofruara nga ana e institucioneve**

**Niveli i kënaqshmërisë me shërbimet e ofruara nga Institucionet**



# Shtojca 3. Letër konfirmimet



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
Republik of Kosovo - Republika Kosova


**KOMUNA E PEJËS**  
Municipality of Peja - Opština Peë

**Drejtoria për Mirëqenie Sociale**



---





**QENDRA PËR PUNË SOCIALE - PEJË**

**LETËR E KONFIRMIMIT**

**QPS Peja**

**949/23**

**03.08.23**

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.


Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit: Pejë, 03.08.2023


i/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

**DREJTORI**  
Drita Kelmendi-Kukaj



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor  
Sekretariati/Sekretariat/Secretariat

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave / Kancelarija za Zastupanje i Pomoć Žrtvama  
Victims Advocacy and Assistance Office

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 11.08.2023  
Prishtinë

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Pas takimit dhe diskutimeve që kishim me datën 11.08.2023 pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.
- Për çdo paqartësi mos hezitoni të na kontaktoni

Ibrahim Tërstena

u.d. Menaxheri i ZMNV-së



|                                                                                                                                                  |                                               |                                     |                                           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO<br>ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT<br>NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE |                                               |                                     |                                           |
| DATUM PRANIMIT / DATE RECEIVED: 11.08.2023                                                                                                       |                                               |                                     |                                           |
| Njësia Org.<br>Org. Jed.in.<br>Org. Unit                                                                                                         | Simboli Klasif.<br>Klasif. Kod<br>Class. Code | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No. | Nr. i faqeve<br>Br. Stranica<br>No. Pages |
| 06                                                                                                                                               | 47                                            | 351                                 | 1                                         |



|                                                                                   |                                                                                                                        |                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  | Republika e Kosovës<br>Republika Kosova – Republic of Kosovo<br>Qeveria – Vlada – Government                           |  |
|                                                                                   | Ministria e Punëve të Brendshme<br>Ministry of Internal Affairs<br>Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police |                                                                                     |
|                                                                                   | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/<br>Generalna Policijska Direkcija/ General Police Directorate                     |                                                                                     |

## MEMORANDUM ZYRT SLUJBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM

PËR: Zyra auditorit të përgjithshëm  
ZA:  
TO:

Data: 17.08.2023  
Datum:  
Date:

PËRMES: Z. Gazmend HOXHA  
PREKO: Drejtor i Përgjithshëm i Policisë  
THROUGH: Drejtor Nënkolonel Arbnes M. AJVAZI, Ref.DDRP 05/01/-02/80/23  
UD/Drejtor i Departamentit të Rendit Publik-DPP


PREJ: Nënkolonel Zylfije DEMA  
OD: Drejtor i Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Parandalim  
FROM: DPP-Prishtinë

LËNDA:  
PREMET: Leterkonfirmi për auditorin e përgjithshëm  
SUBJECT:

|                                                                                                                                                  |                                             |                                     |                                           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO<br>ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT<br>NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE |                                             |                                     |                                           |
| DITËSHKRIMI DOKUMENTI<br>DOKUMENTI DOKUMENTI<br>DOKUMENTI DOKUMENTI                                                                              |                                             |                                     |                                           |
| Nr. Org.<br>Org. Jedn.<br>Org. Unit                                                                                                              | Stufi/Klasif.<br>Klasif. Kod<br>Class. Code | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No. | Nr. Transp.<br>Dr. Transp.<br>No. Transp. |
| 06                                                                                                                                               | 47                                          | 1365                                | 2                                         |

Të nderuar,

Bashkangjitur me këtë shkresë përcjellëse kenë letërkonfirmin lidhur me rekomandimet e dalura gjatë auditimit të performances "Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje".



## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të përfomancës **“Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Ref: DDRP 05/01-02/80/2023

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 17.08.2023

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:


- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Drejtore i Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Parandalim


 Nënkolonel Zylfije Dema





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

*Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice*

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 18 gusht 2023

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Ministria e Drejtësisë (MD) ka pranuar Draft-raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Efektiviteti i institucioneve në trajtimin e rasteve të dhunës në familje”** (në tekstin e mëtejme **“Raporti”**);
- Ministria e Drejtësisë ka ofruar komentet në Draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe pajtohet me Draft-raportin së bashku me komentet e përfshira dhe dëshmitë e ofruara nga MD lidhur me përmbajtjen e Draftit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, MD do ta dorëzojë një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



EFEKTIVITETI I INSTITUCIONEVE  
NË TRAJTIMIN E RASTEVE  
TË DHUNËS NË FAMILJE

Zyra Kombëtare e Auditimit  
Lagjja Arbëria  
Rr. Ahmet Krasniqi, 210  
10000 Prishtina  
Republika e Kosovës